



KPP
Komisioni i Prokurimit Publik

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK



TRANSPARENCË, BARAZI, EFIÇENCË

Raporti Vjetor 2021

Letër drejtuar Kuvendit të Shqipërisë

*E nderuar znj. Kryetare,
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,*

*Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", është nder
të dorëzosh para Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, raportin vjetor të veprimtarisë
së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2021.*

I juaji sinqerisht,

*Jonaid Myzyri
Kryetar
Komisioni i Prokurimit Publik*



PËRMBAJTJA

FJALA E KRYETARIT 5

I PËRMBLEDHJE 10

1. Roli dhe Statusi i Komisionit të Prokurimit Publik 10
2. Mbi përcaktimet ligjore lidhur me raportimin vjetor 13
3. Veprimtaria gjatë vitit 2021 14
4. Pikat kryesore 16

II INDIKATORËT KRAHASIMORË MBI VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2021 28

1. Koha e shqyrtimit të ankesës 28
2. Vendime të Komisionit të Prokurimit Publik të ankimuara në gjykatë 30
3. Realizimi i buxhetit 31

III VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË ANKESAVE 32

1. Të dhëna të përgjithshme statistikore mbi llojet e ankesave të paraqitura në komisionin e prokurimit publik 32
2. Të dhëna statistikore për numrin total të ankesave sipas fazës për të cilën është paraqitur ankimi 34
3. Të dhëna statistikore për numrin total të ankesave sipas llojit të kontratës për punë, mall, shërbim 38
4. Të dhëna të përgjithshme statistikore për vendimmarrjen e komisionit të prokurimit publik 40


5. Seancat dëgjimore 42
6. Vendimet për ekspertizë 44
7. Vendimet interpretuese 44
8. Kushtet për pranimin e ankimeve dhe arsyet më të zakonshme për paraqitjen e tyre 45
9. Problemet e identifikuara në funksionimin e sistemit të ankimit për prokurimin publik 48
10. Monitorimi i zbatimit të vendimeve dhe masat ndëshkuese 52
11. Proceset gjyqësore lidhur me vendimet e komisionit të prokurimit publik për periudhën janar 2021-dhjetor 2021 55
12. E drejta për informim 58

IV PERFORMANCA FINANCIARE 60

1. Realizimi i buxhetit të komisionit të prokurimit publik për vitin 2021 60
2. Parashtrime mbi mjaftueshmërinë e fondeve 62
3. Të ardhurat jashtëbuxhetore për vitin 2021 64

V ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I INSTITUCIONIT 70

1. Rregulla të organizimit dhe parimet kryesore të funksionimit 70
2. Struktura dhe organika 73
3. Politika të menaxhimit të burimeve njerëzore 76



FJALA E KRYETARIT

VI	DIGJITALIZIMI I SHËRBIMEVE	80
VII	BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE AKTIVITETET	86
VIII	BASHKËPUNIMI DHE MARRËDHËNIET ME PARTNERË VENDAS DHE TË HUAJ	94
IX	MBI ZBATIMIN E REZOLUTËS SË KUVENDIT DATË 03.06.2021	96
X	OBJEKTIVA PËR TË ARDHMEN	100

Paraqitja e raportit vjetor para Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si dhe grupeve të interesit, nuk është thjesht një detyrim ligjor për institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik. Ky raport është një mundësi për të analizuar në detaje punën e një viti, për të evidentuar problematikat, por mbi të gjitha, për të ndarë së bashku sfidat e sistemit të prokurimit publik për të ardhmen.

Viti 2021 ishte një vit shumë i rëndësishëm për sistemin e prokurimit publik në Shqipëri, veçanërisht në tri aspekte.

Së pari, viti që lamë pas ishte një vit shënues dhe kthese, për mënyrën e ofrimit të shërbimeve nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Projekti i digjitalizimit të plotë të shërbimeve, i nisur në vitin paraardhës, u arrit të finalizohet me sukses. Nga tetori i vitit të kaluar, të gjithë operatorët ekonomikë vendas dhe të huaj, kanë mundësinë të dorëzojnë elektronikisht ankesat dhe argumentet e tyre si dy shërbime të veçuara, duke zeruar kostot ekstra dhe kontaktin e drejtpërdrejtë me çdo zyrë shteti, përfshirë dhe vetë Komisionin e Prokurimit Publik. Sistemi mundëson edhe nënshkrimin elektronik, duke shmangur nevojën e printimit të dokumenteve voluminoze dhe nënshkrimit të akteve, veprimtari e cila ndikon në mënyrë të drejtpërdrejte në mbrojtjen e mjedisit.

Sistemi shoqërohet me një faqe të re zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik, e cila mundëson aksesueshmëri të plotë të vendimmarrjes në tri regjistra publikë, atë të ankesave, vendimeve dhe historikut të vendimeve. Çdo subjekt i interesuar, jo vetëm që disponon informacion të plotë në lidhje me të gjithë veprimtarinë, por ka mundësi, që përmes motorëve të kërkimit të Smart Search, të kërkojë pa humbur kohë informacionin e nevojshëm.

Vizioni ynë ishte i qartë që në pikënisjen e tij. KPP-ja duhet të ofrojë informacion në kohë reale për të gjithë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuar në shikim: verbëri, verbëri ngjyrash, rezolucion të ulët në shikim. Një motor i posaçëm aksesimi është implementuar në faqen tonë zyrtare, shërbim i ofruar për herë të parë nga një institucion publik në Shqipëri.

Ne, jo vetëm që kemi vendosur të jemi transparentë, por nivelin e transparencës ta përkthejmë në standardin më të mirë ndërkombëtar që është sot për sot në fushën e prokurimeve, atë të Open Contracting Partnership. Të vendosësh në standard të hapur të gjithë vendimmarrjen e institucionit nuk është e lehtë dhe jo të gjithë do të jenë të kënaqur, por ne jemi të ndërgjegjshëm, se kjo është rruga e vetme për institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik: Të jetë i hapur, transparent dhe të mundësojë akses të plotë të veprimtarisë së tij.

Kjo reformë dhe kjo politikë kaq e rëndësishme publike, me një impakt të drejtpërdrejtë social në të gjitha grupet e interesit, nisur nga një institucion i vogël, por hallkë tepër e rëndësishme në zinxhirin e prokurimit, nuk do të kishte qenë kurrësi e mundur pa mbështetjen e Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

Mbështetja ndaj zërit dhe kërkesës së një institucioni të pavarur ka qenë esenciale në përfundimin në një kohë rekord, duke e kthyer Shqipërinë, në një ndër vendet e para dhe të pakta në rajon dhe në botë, që ka përfshirë edhe procesin e dorëzimit dhe të shqyrtimit të ankesave online në fushën e prokurimeve, si dhe një nivel krejt të ri të transparencës së organeve të shqyrtimit të ankesave.

Procesi i kalimit nga analog në digjital, nga dokumentacion shkresor në JSON, nuk është një rrugë e lehtë, ndaj ne jemi mbështetur në ekspertizën më të mirë ndërkombëtare, atë të Open Contracting Partnership.

Kësisoj, Shqipëria është kthyer në promotore të një standardi të ri të publikimit të veprimtarisë së organit shqyrtues të ankesave në rang rajonal dhe më gjerë.

Që në krye të herës jemi kujdesur, që ky sistem të ndërtohet në konsultim të përbashkët me biznesin, përfaqësuar nga Unioni i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, ndaj për më shumë se një muaj kemi qenë në çdo qark, për të trajnuar falas mbi 1000 operatorë ekonomikë dhe autoritete kontraktore, me mbi 24 orë trajnimi.

Reforma e digjitalizimit është ndërlidhur edhe me reformën e forcimit të kapaciteteve të institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik. Në zbatim të rekomandimeve, si të Kuvendit të Shqipërisë ashtu edhe të Komisionit Europian, falë edhe mbështetjes së Kuvendit, KPP-ja në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, hartoi një kurrikul të posaçme trajnimi për zyrtarët e KPP-së. Për më shumë se 196 orë, stafi i Komisionit është trajnuar intensivisht nga pedagogët e tri fakulteteve kryesore në vend.

Gjithashtu, gjatë vitit që lamë pas, kemi dëgjuar edhe sugjerimet për përmirësimin e shqyrtimit të ankesave, me anë të konferencës së organizuar në nivel kombëtar, me më shumë se 70 autoritete kontraktore dhe operatorë ekonomikë.

Së dyti, hyrja në fuqi e ligjit të ri për prokurimin publik, ka sjellë një moment të rëndësishëm për sistemin në tërësi. Ligji i ri ka sjellë ndryshime thelbësore materiale dhe procedurale, ndaj dhe përgjegjësia e Komisionit të Prokurimit Publik ka qenë edhe më e lartë në vendosjen e praktikave të konsoliduara, mbi trajtimin e çështjeve të reja për këtë institucion, në dhjetëvjeçarin e funksionimit të tij.

Nga 5079 procedura të publikuara në Sistemin e Prokurimeve Elektronike gjatë vitit 2021, janë administruar 768 ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nga të cilat, 3 prej tyre për procedura ankandi, 1 lidhur me lejet minerare, 2 ankesa në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe 762 për procedurat e prokurimit publik, të cilat përbëjnë 9.2 % të buxhetit të prokuruar në rang kombëtar.

Gjatë vitit 2021, Komisioni është shprehur me 676 vendime përfundimtare, me një kohë mesatare të trajtimit të ankesave prej 16 ditësh, ndërkohë numri i ankesave të trajtuara jashtë afatit ligjor, ka rënë me 50 % nga viti paraardhës, me treguesit më të mirë në dhjetëvjeçarin e funksionimit të tij.

Në këtë periudhë KPP-ja, ka marrë tri masa administrative gjobë për titullarët e autoriteteve kontraktore, ka dërguar për hetime të mëtejshme tri çështje pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe për hetime administrative njëmbëdhjetë çështje pranë Agjencisë së Prokurimit Publik.

Për herë të parë në dhjetëvjeçarin e fundit, KPP-ja është shprehur edhe me vendime interpretuese, duke publikuar njëherazi në faqen zyrtare dhe buletinet periodike, për të gjithë operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore, njoftime mbi praktikën vendimmarrëse në çështje specifike, me rëndësi për sistemin dhe me synim shmangien e përsëritjes së problematikave të konstatuara.

Qëndrueshmëria e vendimmarrjes së Komisionit është konfirmuar edhe nga Gjykata administrative, si në drejtim të numrit më të ulët të padive të paraqitura kundër vendimeve të Komisionit krahasuar me vitet e mëparshme, por edhe në raport me vendimmarrjen e Gjykatës, ku vetëm 6 vendimmarrje të Komisionit janë ndryshuar nga Gjykata dhe jo me një vendim të formës së prerë.

Së treti, viti i kaluar ka qenë një vit i rëndësishëm edhe për vlerësimin në aspektin ndërkombëtar të prokurimit publik në Shqipëri, veçanërisht të punës së Komisionit të Prokurimit Publik. Në raportin e SIGMA-OECD për "Reformat e mirëqeverisjes dhe Administrimit Publik", për vitin 2021 theksohet, se performanca e Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) është përmirësuar ndjeshëm, ku fokusi vendoset te sistemi i ri i apelimit elektronik, rritja e shpejtësisë së vendimmarrjes dhe faqja e re Uebit. Sfidat që ndan sistemi i prokurimit publik në tërësi dhe Komisioni i Prokurimit

Publik, bashkohen në një, ajo e forcimit të kapaciteteve dhe elementeve njerëzore, të zyrtarëve të prokurimit dhe të çdo zyrtari, që shqyrton procedurat e prokurimit, qoftë organ administrativ apo organ gjyqësor.

Çdo reformë institucionale dhe funksionale nuk do të kishte kuptim pa prekur thelbin e saj, elementin njerëzor. Një trupë zyrtarësh prokurimi të certifikuar pranë autoriteteve kontraktore, operatorëve ekonomikë, organeve të shqyrtimit të prokurimit por edhe gjykatës, do të sillte një impakt të qenësishëm në sistemin e prokurimit në Shqipëri.

Komisioni i Prokurimit Publik, garanton të gjitha grupet e interesit, se do të vijojë në lartësinë e kërkuar nga ligji dhe të besuar nga Kuvendi, për të mbrojtur interesat e ligjshëm, si një organ që qëndron mbi palët dhe me emërues të përbashkët pasionin për të punuar me paanshmëri, ligjshmëri, shpejtësi dhe efçencë.

Jonaid MYZYRI

Kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik





PËRMBLEDHJE

1. Roli dhe Statusi i Komisionit të Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit publik, koncesionet/partneritetin publik privat, ankandet publike dhe procedurat konkurruese të dhënies së lejeve minerare, organ i krijuar me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”, përkatësisht me ligjin nr.10 170, datë 22.10.2009.

Komisioni ka statusin e një institucioni të pavarur, i cili financohet nga buxheti i shtetit, status i cili u sanksionua me ndryshimet e bëra me ligjin nr.47/2017, datë 13.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), në përmbushje të marrëveshjeve me partnerët ndërkombëtarë, në veçanti me Bashkimin Evropian dhe Bankën Botërore, si dhe të objektivave të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020. Referuar përcaktimeve të ligjit të prokurimit publik, Komisioni i Prokurimit Publik, ka detyrimin ligjor, t’i raportojë Kuvendit nëpërmjet një raportimi vjetor, i cili kryhet në fund të tremujorit të vitit pasardhës dhe prezantohet nga Kryetari i Komisionit. Gjithashtu, me kërkesë të Kuvendit, Komisioni i Prokurimit Publik mund të raportojë edhe për periudha më të shkurtra kohore apo për çështje të caktuara.



Prej 31 Marsit të vitit 2021, ka hyrë në fuqi ligji i ri i prokurimit publik nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili ka sjellë përafrim me katër direktiva, Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin publik; Direktivën 2014/25/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin nga entet që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare; Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989, “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike, e ndryshuar”; Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989, “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike, e ndryshuar”. Ligji i ri për prokurimin publik i cili parashikon rolin dhe statusin e Komisionit të Prokurimit Publik,

ka sjellë ndryshime thelbësore materiale dhe procedurale në lidhje me procesin e shqyrtimit të ankesave nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Raportimi vjetor i Komisionit të Prokurimit Publik, është një ndër format dhe mënyrat kryesore, nëpërmjet të cilit, pasqyrohet dhe evidentohet veprimtaria e këtij institucioni të pavarur, sigurohet llogaridhënia para Kuvendit të Shqipërisë dhe niveli i nevojshëm i përgjegjshmërisë. Ky raport është njëkohësisht një ndër aspektet e punës dhe një ndër format me të cilën sigurohet transparencë dhe bërja publike e veprimtarisë së tij, në kuadër të respektimit të parimit të transparencës, interesit publik, sigurimit të mbrojtjes së të drejtave të operatorëve ekonomikë dhe zbatimit të legjislacionit përkatës nga ana e autoriteteve kontraktore.

2. Mbi përcaktimet ligjore lidhur me raportimin vjetor

Raporti vjetor, përfshirë edhe raportimin për vitin 2021, në respekt të nenit 32 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” mbi veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik, detyrimisht duhet të përfshijë krahas performancës buxhetore dhe financiare, politikat/administrimin e burimeve njerëzore, marrëdhëniet institucionale me partnerët vendas dhe të huaj, edhe paraqitjen në mënyrë të detajuar lidhur me të dhënat mbi; a) numrin total të ankimeve dhe vlerën e tyre për secilin autoritet ose ent kontraktor, llojin e procedurës së prokurimit, si dhe fazën e procesit për të cilin është paraqitur ankimi; b) numrin total të ankimeve të refuzuara dhe vlerën e tyre për secilin autoritet ose ent kontraktor, llojin e procedurës së prokurimit, si dhe fazën e procesit për të cilin është paraqitur ankimi; c) numrin total të ankimeve të pranuar dhe vlerën e tyre për secilin autoritet ose ent kontraktor, llojin e procedurës së prokurimit, si dhe fazën e procesit për të cilin është paraqitur ankimi; ç) numrin e vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik të ankimuara në Gjykatën Administrative të Apelit; d) kushtet për pranimin e ankimeve dhe arsyet më të zakonshme për paraqitjen e ankimeve; dh) informacion për problematikat e identifikuara në funksionimin e sistemit të prokurimit publik dhe propozimet për përmirësimin e tyre.

3. Veprimtaria gjate vitit 2021

Janar

I 47 Ankesa të depozituara
58 Vendime të marra nga Komisioni i Prokurimit Publik

Shkurt

I 44 Ankesa të depozituara
47 Vendime të marra nga Komisioni i Prokurimit Publik
25 Shkurt 2021- Miratimi i Rregullores së brendshme të grupit të monitorimit ad hoc, në lidhje me mbikëqyrjen e sjelljes së nëpunësve civil gjatë periudhës së fushatës elektorale, dokument rregullator dhe normues.
28 Shkurt 2021- Raportimi për SIGMA-n lidhur me vlerësimin e Shqipërisë për vitin 2020, në kuadër të përbushjes së detyrimeve ndaj Komisionit Europian.

Mars

I 55 Ankesa të depozituara
39 Vendime të marra nga Komisioni i Prokurimit Publik
29 Mars 2021- Miratimi i Programit të Transparencës të rishikuar me anë të urdhrin nr. 63, datë 29.03.2021, "Për miratimin e programit të transparencës të rishikuar të Komisionit të Prokurimit Publik".
29 Mars 2021- Raportimi në lidhje me përparimin dhe arritjet e realizuara në periudhën 1 qershor 2020-31 mars 2021 nga KPP-ja, në kuadër të kërkesës për fillimin e procesit për hartimin e kontributit të parë të qeverisë shqiptare, për Raportin e Komisionit Europian, për Shqipërinë për vitin 2021.
31 Mars 2021- Hyrja në fuqi e ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik".
31 Mars 2021- Hartimi dhe dërgimi i Raportit vjetor 2020 në Kuvend.

Prill

I 64 Ankesa të depozituara
45 Vendime të marra nga Komisioni i Prokurimit Publik
9 Prill 2021- Miratimi i Procedurës Antikorrupsion në Komisionin e Prokurimit Publik, miratuar me urdhrin nr.96, datë 09.04.2021, "Për miratimin e procedurës antikorrupsion në Komisionin e Prokurimit Publik".
12-13 Prill 2021- Raportimi mbi ecurinë e zbatimit të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022, me qëllim përgatitjen e Raportit Vjetor të Monitorimit për vitin 2020, mbi treguesit/produktet për të cilat është përgjegjës Komisioni i Prokurimit Publik në fushën e prokurimit publik.
27 Prill 2021- Raportimi lidhur me përparimin e arritur në plotësimin dhe përafrimin e legjislacionit, zbatimin e kuadrit ligjor ekzistues, forcimin e kapaciteteve administrative, si dhe masat e ndërmarra për kapërcimin e vështirësive, që nga takimi i Nënkomitetit paraardhës, zhvilluar më datë 22 Prill 2020, në kuadër të fillimit të procesit të hartimit të materialit për takimin e 12-të të Nënkomitetit "Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca, duke përfshirë Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shëndetit".

Maj

I 55 Ankesa të depozituara
59 Vendime të marra nga Komisioni i Prokurimit Publik
20 Maj 2021- Konferenca me temë "Sfidat e sistemit të prokurimit publik në Shqipëri dhe roli i Komisionit të Prokurimit Publik", me pjesëmarrje nga autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë.
27 Maj 2021- Takimi i dymbëdhjetë i Nënkomitetit "Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca", duke përfshirë mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shëndetit, në formë video-konference. Në këtë takim u raportua mbi zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë dhe të Nënkomitetit të fundit të zhvilluar më datë 22 prill 2020.

Qershor

I 77 Ankesa të depozituara
67 Vendime të marra nga Komisioni i Prokurimit Publik
03 Qershor 2021- Prezantimi i Raportit Vjetor 2020 në Kuvend.
03 Qershor 2021- Raportimi i të dhënave statistikore, në përputhje me kërkesën e shërbimeve të Komisionit Europian, për të gjithë vitin 2020, si dhe për periudhën janar – maj 2021, në kuadër të kërkesës për fillimin e procesit për hartimin e kontributit të dytë të qeverisë shqiptare, për Raportin e Komisionit Europian, për Shqipërinë për vitin 2021.
09 Qershor 2021- Hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
09 Qershor 2021- Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Universitetin e Tiranës, për zhvillimin e ciklit të trajnimeve, për rritjen e kapaciteteve të stafit të KPP-së.
11 Qershor 2021- Dërgimi i komenteve lidhur me fazën e dytë të vlerësimit SIGMA 2020, për Shqipërinë.
29 Qershor 2021- Fillimi i marrëdhënieve të punës në zbatim të vendimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr.52, nr.53, nr.54 datë 27.05.2021, "Për emërim në detyrë" të 3 (tre) anëtarëve të rinj të Komisionit të Prokurimit Publik.
30 Qershor 2021- Emërimi i Nënkryetarit (në detyrë) të KPP-së, me vendimin KPP 322/2021, datë 30.06.2021.

Korrik

I 77 Ankesa të depozituara
67 Vendime të marra nga Komisioni i Prokurimit Publik
29 Korrik 2021- Miratimi i rregullores së brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, duke shfuqizuar rregulloren e miratuar me urdhrin nr.39, datë 05.02.2019.
30 Korrik 2021- Raportimi për Strategjinë Kombëtare për Prokurimin Publik, lidhur me qëllimin e politikës 5 "Përmirësimi i sistemit të shqyrtimit të ankesave", për vitin 2020 dhe gjashtëmuorin e parë të vitit 2021.
Nis publikimi i buletineve mujore të veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik. Çdo muaj, KPP-ja publikon në mënyrë të përbledhur të dhëna mbi veprimtarinë dhe njofton elektronikisht të gjitha grupet e interesit.

Gusht

I 66 Ankesa të depozituara
78 Vendime të marra nga Komisioni i Prokurimit Publik
05 Gusht 2021- Raportimi për Kuvendin mbi zbatimin e rezolutës së datës 03.06.2021 "Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2020".

Shtator

I 73 Ankesa të depozituara
78 Vendime të marra nga Komisioni i Prokurimit Publik
30 Shtator 2021- Paraqitja e komenteve për Sigma-n lidhur me draft-raportin e hartuar në kuadër të procesit të vlerësimit të SIGMA 2020 për Shqipërinë.
KPP-ja implementon sistemin e parë të organeve të administratës publike, mbështetur në parimet e ligjit nr.93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar" për aksesimin e informacionit për personat me vështirësi në shikim: verbëri, verbëri ngjyrash dhe rezolucion të ulët në shikim. Përmes këtij sistemi KPP-ja synon, që krahas rritjes së transparencës dhe afrimit të tij në grupet e interesit, të krijojë aksesueshmërinë e informacionit për personat me aftësi të kufizuar dhe të kthejë vëmendjen e shoqërisë në ndërgjegjësimin për barazinë e personave me aftësi të kufizuar, veçanërisht duke garantuar mjetet për mbështetje dhe ndihmë për mundësi dhe kushte të barabarta me të tjerët. KPP-ja informon Shoqatën e të Verbërve dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi për këtë risi.

Tetor

I 80 Ankesa të depozituara
72 Vendime të marra nga Komisioni i Prokurimit Publik
01 Tetor 2021- Raportimi mbi zhvillimet më të fundit, për sa i takon sistemit të shqyrtimit të ankesave për periudhën Qershor-Shtator 2021 në kuadër të kërkesës së dërguar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, për publikimin e Raportit vjetor 2021.
13 Tetor 2021- Miratimi i "Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", me vendimin KPP 766/2021, datë 13.10.2021.
21 Tetor 2021- Raportimi i informacionit statistikor mbi ankesat e paraqitura gjatë periudhës janar-shtator 2021, në kuadër të fillimit të procesit të hartimit të materialit për takimin e 13-të të Nënkomitetit për Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikat.
27 Tetor 2021- Zhvillimi i aktivitetit për promovimin e sistemit të ri digjital të dorëzimit dhe menaxhimit të ankesave (e-ankesa).
28 Tetor 2021- Takimi i Zëvendëskryetares së Kuvendit znj. Ermonela Felaj me Kryetarin e Komisionit të Prokurimit Publik z. Jonaid Myzyri i shoqëruar nga z. Gavin Hayman, drejtor ekzekutiv i Open Contracting Partnership dhe z. Karolis Granickas menaxher për Evropën.
28 Tetor 2021- Raportimi dërguar Kuvendit të Shqipërisë, mbi zbatimin e rezolutës së datës 03.06.2021 "Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2020".

Nëntor

I 64 Ankesa të depozituara
85 Vendime të marra nga Komisioni i Prokurimit Publik
03 Nëntor 2021- Raportimi mbi situatën aktuale, arritjet kryesore, si dhe prioritetet në të ardhmen, të punës së Komisionit të Prokurimit Publik në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE 2022-2024), referuar metodologjisë së hartimit të përgatitur nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ).
04 Nëntor 2021- Nisi zhvillimi i trajnimeve për të gjitha autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë, lidhur me funksionimin e sistemit të ri digjital të ankesave (e-ankesa), të cilat u zhvilluan në të gjitha qarqet, Dibër, Kukës, Fier, Berat, Gjirokastrë, Vlorë, Shkodër, Lezhë, Elbasan, Korçë, dhe u përmbyllën më datë 13.12.2021 me trajnimin e zhvilluar për qarkun e Tiranës dhe Durrësit në Pallatin e Kongreseve.
08 Nëntor 2021- Prezantimi në seancën dëgjimore të mbajtur për shqyrtimin e projektligjit "Për buxhetin e vitit 2022", pranë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Dhjetor

I 66 Ankesa të depozituara
66 Vendime të marra nga Komisioni i Prokurimit Publik
09 Dhjetor 2021- Miratimi i listës vjetore të ekspertëve, specialistëve të pavarur dhe laboratorëve të akredituar për vitin 2022, me vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 983/2021, datë 09.12.2021.
10 Dhjetor 2021- Seminari i parë mbi sfidat e sistemit të prokurimit publik në Shqipëri, rolin e KPP-së dhe mbrojtjen ligjore para Gjykatës, i organizuar nga Komisioni i Prokurimit Publik në bashkëpunim me Sigma OECD dhe Gjykatën Administrative të Apelit.
30 Dhjetor 2021- Raportimi i KPP-së në lidhje me "IPA SMC_ for Democracy & Good Governance", në kuadër të raportimit, lidhur me zbatimin e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike për periudhën janar-dhjetor 2021.
31 Dhjetor 2021- Raportimi dërguar Kuvendit të Shqipërisë mbi zbatimin e rezolutës së datës 03.06.2021 "Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2020".
Dhjetor 2021- Raportimi vjetor pranë ILDKPKI, lidhur me veprimtarinë e kryer në zbatim të ligjit, përfshirë rastet e konfliktit të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklarinimin periodik.

4. Pikat kryesore

4.1. Ankesat dhe lloji i tyre

Nga 5079 procedura të publikuara në Sistemin e Prokurimeve Elektronike gjatë vitit 2021, për prokurime publike me vlerë totale prej 149,320,420,249 lekë, për 566 prej këtyre procedurave me vlerë prej 13,716,561,152 lekë, janë paraqitur ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Në total pranë Komisionit të Prokurimit Publik, janë paraqitur ankesa **për 9.2 %** të buxhetit të prokuruar në rang kombëtar.

Për vitin 2021, janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik 768 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) ankesa në total, nga të cilat: 762 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy) janë ankesa në lidhje me procedura të prokurimit publik, 3 (tre) ankesa për procedura ankandi, 1 (një) ankesë lidhur me lejet minerare dhe 2 (dy) ankesa në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Gjithashtu, me ndryshimet ligjore operatorët ekonomikë legjitimohen për të paraqitur ankesë për herë të parë në dhjetë vitet e fundit pranë Komisionit të Prokurimit Publik edhe për procedurat e prokurimit *me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*. Gjatë vitit 2021, pranë KPP-së janë paraqitur dy ankesa në lidhje me procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, një ankesë në lidhje me dokumentet e tenderit dhe një ankesë në lidhje me mënyrën e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të ftuar në procedurë nga autoriteti kontraktor.

Megjithëse, gjatë vitit 2021, janë publikuar 1361 procedura prokurimi më pak se në vitin 2020. Vihet re një rritje e lehtë e numrit të ankesave të paraqitura pranë Komisionit të Prokurimit Publik me 27 ankesa ose një rritje me 3.7 % të numrit të ankesave.

¹ (2021). *Analiza Vjetore*. Tirana: APP.

2021 NË NUMRA



5079 procedura në SPE fondi limit 149,320,420,249



566 të ankimura në KPP vlera 13,716,561,152/9.2 % e buxhetit

të prokuruar në rang kombëtar



768 ankesa

762 ankesa, procedura të prokurimit publik

3 ankesa, procedura ankandi

1 ankesë, për leje minerare

2 ankesa, fusha e mbrojtjes dhe sigurisë



Rritje e numrit të ankesave 27 krahasuar me 2020

Rritje me 3.7 % të numrit të ankesave

Rritja e numrit të ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kryesisht lidhet me dy faktorë: ndryshimi i ligjit për prokurimin publik, i cili hyri në fuqi më datë 31 mars të vitit 2021, duke sjellë ndryshime thelbësore në aspektin material, si edhe ndryshimet ligjore në aspektin procedural të paraqitjes së ankesave.

Nga 768 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) ankesa, 298 prej tyre ose rreth 38.8 %, janë ankesa të paraqitura për kundërshtime mbi dokumentet e tenderit dhe 470 ankesa ose rreth 61.2 % e tyre, janë ankesa të paraqitura për fazën e vlerësimit të ofertave.

Nga numri total i ankesave të paraqitura gjatë vitit 2021, prej 768 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) ankesa në total, janë pranuar 327 (treqind e njëzet e shtatë) ankesa, nuk janë pranuar 343 (treqind e dyzet e tre), nuk janë marrë në shqyrtim 31 (tridhjetë e një) ankesa; është mbyllur çështja për 54 (pesëdhjetë e katër), si dhe ka përfunduar procedimi administrativ për 21 (njëzet e një) prej tyre. Detajet mbi vlerën për secilin autoritet kontraktor, si dhe objektin e kontratës, si punë, mall, shërbim, etj. i gjeni të detajuara në aneksin nr.1, pjesë përbërëse e këtij raporti.

Gjatë vitit 2021, numri total i autoriteteve kontraktore për të cilat është paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik është 223 (dyqind e njëzet e tre), ndërkohë që numri i operatorëve ekonomikë ankimues është 283 (dyqind e tetëdhjetë e tre). Detajet mbi fondin limit për secilin autoritet kontraktor, si dhe objektin e kontratës, si punë, mall, shërbim etj., i gjeni të detajuara në aneksin nr.1, pjesë përbërëse e këtij raporti.

**768 ankesa**

298 ose rreth 38.8 %, ankesa të paraqitura për dokumentet e tenderit
470 ose rreth 61.2 % e tyre, ankesa për fazën e vlerësimit të ofertave


327 ankesa pranuar**343 nuk janë pranuar****31 ankesa nuk janë marrë në shqyrtim****Për 54 ankesa është mbyllur çështja****Për 21 ankesa ka përfunduar procedimi administrativ****Paraqitur ankesë për 223 autoritete kontraktore****Paraqitur ankesë nga 283 operatorë ekonomikë****676 vendime****53 ankimuar në gjykatë****6 kërkesëpadi pranuar****23 kërkesëpadi rëzuar**

Vendimmarrja e Komisionit

Nga 676 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) vendime të marra nga Komisioni i Prokurimit Publik gjatë vitit 2021, janë kundërshtuar me kërkesëpadi në Gjykatë, 53 (pesëdhjetë e tre) prej tyre. Nga totali i padive të paraqitura, për 6 prej tyre është vendosur pranimi i kërkesëpadisë së paraqitur nga operatorët ekonomikë, si dhe është rrëzuar padia në 23 (njëzet e tre) raste, duke mbajtur të njëjtin qëndrim me vendimmarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik. Pjesa tjetër e rasteve për të cilat është proceduar me padi janë në proces gjyqësor.

Në krahasim me vitin 2020, ka një ulje të vendimeve të ankimuara pranë Gjykatës Administrative, nga 9.8 % të vendimeve të ankimuara në vitin 2020, në 7.8 % të vendimeve të ankimuara në vitin 2021.

Gjatë vitit 2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka rritur shpejtësinë e shqyrtimit të ankesave, si në drejtim të numrit total të ankesave të trajtuara jashtë afatit, gjithashtu edhe në numrin e ditëve të trajtimit të një ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Kështu që, nëse për vitin 2020 përqindja e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit ishte në vlerën 22.1 %, në vitin 2021 përqindja e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit është ulur në vlerën 10.8 %, dhe koha e vendimmarrjes për vitin 2021 është 17 ditë, nga 20 ditë që ishte për vitin 2020.



Objektivi kryesor i Komisionit të Prokurimit Publik është mbrojtja e interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë nga veprimet apo mosveprimet e autoriteteve kontraktore në zbatimin e ligjshmërisë, në lidhje me prokurimin publik.

Çështjet që janë trajtuar në vendimmarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik gjatë vitit 2021 kanë pasur të bëjnë me:

- (i) Aplikimin e rregullave për përcaktimin e fondit limit;
- (ii) Mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike
- (iii) Mënyrën e hartimit të kërkesave dhe dokumenteve provuese në lidhje me kriteret e kualifikimit;
- (iv) Mënyrën e hartimit të kriterëve të përcaktimit të ofertues fituese;
- (v) Vendosjen e kërkesave të tepërta, të panevojshme ose jo në proporcion me natyrën, volumin dhe me objektin e prokurimit, për certifikime e akreditime kombëtare ose ndërkombëtare;
- (vi) Skualifikime apo kualifikime të padrejta dhe të pabazuara në ligj dhe në rregullat e prokurimit të operatorëve ekonomikë;
- (vii) Mosrespektim të rregullave për njoftimet, afatet dhe procedurat e kualifikimit dhe përzgjedhjes;
- (viii) Veprimet procedurale të administrimit dhe kryerjes së vlerësimit dhe testimit të mostrave nga ana e autoriteteve kontraktore
- (ix) Veprimet e autoriteteve kontraktore në drejtim të konstatimit dhe vlerësimit të ofertave të dorëzuara si anomalish të ulëta.
- (x) Mosrespektimi i periudhës së pritjes nga autoritetet kontraktore

Efektet financiare të vendimmarrjes në ankesat për fazën e vlerësimit - kursimi në buxhetin e shtetit

Gjatë vitit 2021, nga totali i ankesave të shqyrtuara, 483 (katërqind e tetëdhjetë e tre) prej tyre janë paraqitur për fazën e vlerësimit të ofertave. Pas vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik rezultojnë, se pas ushtrimit të mjeteve të rishikimit, ankimit administrativ nga operatorët ekonomikë me anë të dorëzimit të ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik, KPP-ja pas shqyrtimit të ankesave, nga vendimmarrja e këtij të fundit, i ka kursyer buxhetit të shtetit, vlerën prej rreth 119,346,291 lekë pa TVSH, llogaritur si diferencë e ofertës së kualifikuar nga vendimmarrja e autoriteteve kontraktore dhe e operatorëve ekonomikë të ankuar, ankesa e të cilëve është pranuar nga Komisioni i Prokurimit Publik.

- (i) Komisioni i Prokurimit Publik në raportet me organizatat ndërkombëtare

Raporti i Sigma-OECD²- Vlerësimi i Reformës në Administratën Publike për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë.

Në këtë raport, sistemi i trajtimit të ankesave në Shqipëri, ka marrë vlerësimin maksimal 5/5, vlerësim i rritur ndjeshëm në krahasim me vlerësimet e viteve paraardhëse. Vlerësohen pozitivisht disa indikatorë si: rritja e shpejtësisë në vendimmarrje; ulja e numrit të ankesave të shqyrtuara jashtë afatit; cilësia e vendimmarrjes; efikasiteti i sistemit të trajtimit të ankesës, etj.

Krahasuar me periudhat e mëparshme në raport konstatohet, se numri i ankesave të shqyrtuara jashtë afatit ligjor nga KPP-ja është ulur konsiderueshëm. Sa i përket rritjes së performancës së KPP-së, zbatimi me korrektësi i afateve të pranimit të ankesës, respektimi i afateve kohore të vendimmarrjes dhe në mënyrë të veçantë cilësia e vendimmarrjes, ka nxjerrë në pah një tjetër tregues shumë të rëndësishëm, atë të uljes së numrit të vendimeve të rrëzuara nga gjykata administrative, duke e përmirësuar këtë indikator në krahasim me periudhat e mëparshme, indikator ky i vlerësuar edhe në progres-raport. Për më shumë shihni tabelën:

² (SIGMA-OECD, 2021)

Tabela nr. 1

Tabela mbi performancën e Komisionit të Prokurimit Publik, vlerësimet 2017, 2020

Nr.	Performanca e Komisionit të Prokurimit Publik në rrafsh krahasimor	2017 Vlerësimi	2021 Vlerësimi
1	E drejta për të kundërshtuar vendimet e procedurave të prokurimit publik	80	100
2	Zhvendosja e mekanizmave për të shmangur joefektivitetin e kontratave dhe vënien e gjobave	33	100
3	Mekanizmat për të siguruar zbatimin e vendimeve të organit shqyrtues KPP-së	0	100
4	E drejta për të kundërshtuar vendimet e organit shqyrtues KPP-së	100	100
5	Dispozitat ligjore sigurojnë pavarësinë e organit shqyrtues dhe anëtarëve të tij	71	100
6	Përshtatshmëria e strukturës organizative dhe procedurat e organit shqyrtues	75	100
7	Koha aktuale e përpunimit të ankesave	33	66
8	Paraqitja e ankesës në praktikë	25	100
9	Cilësia e vendimmarrjes nga organi shqyrtues	50	100
10	Rastet e ndryshuara ose të rishqyrtuara pas verifikimit nga gjykata (%)	100	50
11	Afati kohor dhe efektiviteti i sistemit të trajtimit të ankesave për PPP/koncesione	60	100

Shqipëria në krahasim me vendet e tjera të rajonit, si Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia, rezultojnë të ketë patur rritje të dukshme në lidhje me këto indikatorë. Konkretisht, në krahasim me vendet e tjera të rajonit, si Kosova dhe Mali i Zi, rezultojnë të jetë vlerësuar maksimalisht në lidhje me këto indikatorë: **1-Zhvendosja e mekanizmave për të shmangur joefektivitetin e kontratave dhe**

vënien e gjobave. 2- Pavarësinë e organit shqyrtues. 3- Strukturën organizative dhe procedurat e organit shqyrtues. 4- Kohëzgjatjen e vendimmarrjes dhe efektivitetin e sistemit të trajtimit të ankesave për PPP / koncesione. Ndërsa në krahasim Serbinë dhe Malin e Zi rezultojnë të jetë vlerësuar maksimalisht lidhur me indikatorin: 1- Paanësia në normat e tarifave për fillimin e procedurave të ankesave (rishikimit). Në krahasim me Malin e Zi, rezultojnë të jetë vlerësuar maksimalisht lidhur me indikatorin: 1- Cilësinë e vendimeve, ndërsa në krahasim me vendet e tjera të rajonit si Kosova, Maqedonia, Serbia rezultojnë të jetë vlerësuar maksimalisht lidhur me indikatorin: 1- Përqindja e rasteve të ndryshuara pas vendimit të gjykatës.

Për më shumë shihni tabelën më poshtë:

Tabela nr. 2

Tabela mbi performancën e shteteve të rajonit lidhur me shqyrtimin e ankesave të prokurimit publik, vlerësimet 2017, 2020.

Nr.	ALB		XKV		MNE		MNE		MKD		SRB	
	2017	2021	2017	2021	2017	2019	2021	2017	2021	2017	2021	
1	80	100	100	100	40	40	100	100	100	100	100	100
2	100	0	100	100	100	100	100	100	0	100	100	100
3	33.3	100	66.6	66.6	33.3	33.3	33.3	66.6	100	66.6	100	100

Nr.	2017	2021	2017	2021	2017	2019	2021	2017	2021	2017	2021
4	0	100	0	100	100	100	100	100	100	100	100
5	100	100	100	100	100	100	100	100	100	0	0
6	71.4	100	85.7	85.7	57.1	71.4	100	100	100	100	100
7	75	75	50	50	25	75	50	100	100	75	75
8	75	100	75	75	75	75	75	75	75	75	50
9	33.3	33.3	33.3	33.3	0	0	0	66.6	66.6	33.3	0
10	33.3	66.6	66.6	0	33.3	33.3	66.6	100	100	33.3	66.6
11	25	100	75	100	75	75	100	50	100	0	75

Nr.		2017	2021	2017	2021	2017	2019	2021	2017	2021	2017	2021
12	Cilësia e vendimmarrjes nga organi shqyrtues	50	100	75	100	75	75	50	75	100	100	100
13	Rastet e ndryshuara ose të rishqyrtuara pas verifikimit nga gjykata (%)	100	50	0	50	50	50	0	50	100	50	100
14	E drejta për të kundërshtuar ligjshmërinë e veprimeve/mosveprimeve në procedurat e PPP/koncesioneve	100	100	100	100	0	0	60	100	100	100	100
15	Dispozitat ligjore sigurojnë pavarësinë e organit shqyrtues për PPP/koncesione dhe anëtarët e saj	100	100	100	100	0	0	100	100	100	100	100
16	Afati kohor dhe efektiviteti i sistemit të trajtimit të ankesave për PPP/koncesione	60	100	20	40	0	0	40	100	100	100	100

Digjitalizimi dhe transparencja si mjet i luftës antikorruption

Gjatë vitit 2021, institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik implementoi reformën më të rëndësishme të digjitalizimit të shërbimeve dhe menaxhimit të ankesave. Kjo reformë, konsiston në dorëzimin në rrugë elektronike të ankesave dhe argumenteve, si dy shërbime të veçanta në portalin unik qeveritar e-albania. Operatorët ekonomikë vendas dhe të huaj kanë mundësi, që të dorëzojnë online të gjitha ankesat për procedurat e prokurimit publik, koncesionet/partneritetet publike private, ankandet dhe garat konkurruese të lejeve minerare, duke kursyer kohë, para dhe duke shkurtuar burokracinë.

Ky sistem, i krijuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, ka mundësuar kryerjen në rrugë digjitale, të çdo detyre dhe procesi pune parashikuar nga ligji, si për Autoritetet Kontraktore ashtu dhe për Komisionin e Prokurimit Publik.

Sistemi iu mundëson operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve kontraktore, të nënshkruajnë në mënyrë elektronike dokumentet dhe aktet, duke shmangur kështu nevojën e printimit të tyre, me ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu, tarifa e ankesës mund të paguhet nëpërmjet sistemit unik të pagesave të qeverisë në e-Albania, ose me transfertë bankare.

KPP-ja gjatë vitit 2021, ka dhënë kontribut në themelin e një niveli të ri të transparencës në organet e shqyrtimit të ankesave. Uebsjati ofron një transparencë të plotë bazuar në parimet open data, për të cilën Komisioni ka bashkëpunuar me Open Contracting Partnership. Informacioni publikohet gjithashtu edhe në formatin JSON.

Uebsjati ofron akses edhe për personat me probleme në shikim (verbëri, verbëri ngjyrashdeshikimi i dobët) nëpërmjet një motori të veçantë aksesit të implementuar, shërbim i ofruar për herë të parë nga një institucion publik në Shqipëri.

Gjithashtu, duke nisur nga muaji Korrik 2021, institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik, publikon të dhëna mbi veprimtarinë, edhe në formën e buletineve mujore të publikuara në faqen e uebit, për të cilat njoftohen elektronikisht të gjitha grupet e interesit, si edhe operatorët ekonomikë të regjistruar në bazën e të dhënave të Komisionit të Prokurimit Publik.

INDIKATORËT KRAHASIMORË MBI VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2021

II

1.Koha e shqyrtimit të ankesës

Krahas elementeve shumë të rëndësishme, si zbatimi korrekt i ligjit në procesin e shqyrtimit të ankesave, qëndrueshmëria në vendimmarrje, një element shumë i rëndësishëm është edhe koha e shqyrtimit të ankesave, për të mundësuar sigurimin e së drejtës. Vlen për t'u theksuar, se Komisioni i Prokurimit Publik, ka përsheptuar kohën e

shqyrtimit të ankesave për vitin 2021, duke ulur ndjeshëm treguesin e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit. Konkretisht për vitin 2021 përqindja e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit, është ulur në vlerën 10.8 %, nga 22.1 % që ishte në vitin 2020, ndërsa koha e vendimmarrjes për vitin 2021 është 17 ditë, nga 20 ditë që ishte për vitin 2020, duke rritur shpejtësinë në vendimmarrje me 50 % gjatë vitit 2021.

Tabela nr. 3

	Ankesa të shqyrtuara jashtë afatit	Ankesa të shqyrtuara brenda afatit	Numri gjithsej i ankesave	Përqindja e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit
2020	164	577	741	22.1%
2021	84	692	776	10.8%

2.Vendime të Komisionit të Prokurimit Publik të ankimuar në gjykatë


Në nivel krahasimor, numri i padive të ngritura në gjykatë gjatë vitit 2021, është më i ulët se numri i padive të ngritura gjatë vitit 2020, ndërkohë që numri i vendimeve të KPP-së, është më i lartë gjatë vitit 2021. Përqindja e padive të ngritura në gjykatë për vendimmarrjet e vitit 2020 është 9.8%, ndërsa për vitin 2021 është 7.8%, pra 2% më e ulët.

Tabela nr. 4


	2020	2021
Totali i vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik	601	676
Ankimuar në gjykatë	59	53
Krahasimi i numrit të padive të viteve 2020-2021 në përqindje	9.8%	7.8%

Grafik nr. 1
Viti 2020

- Totali i vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik
- Ankimuar në gjykatë


Grafik nr. 2
Viti 2021

- Totali i vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik
- Ankimuar në gjykatë



3.Realizimi i buxhetit

Në terma totale buxhetore, realizimi i buxhetit të vitit 2021 (përfshirë të gjithë zërat e buxhetit 600-601, 602-606, 231), është realizuar në vlerën 82.4%, krahasuar me buxhetin e vitit 2020 (përfshirë të gjithë zërat e buxhetit 600-601, 602-606, 231), ku realizimi i buxhetit ka qenë në masën 65.20% më shumë. Pra në vitin 2021, buxheti i institucionit, është realizuar në masën 16.84% më shumë.

Tabela nr. 5

	Emërtimi	Realizim buxheti për vitin 2021	Realizim buxheti për vitin 2020
		në %	në %
NR.	BUXHETI I KPP	82.04%	65.20%

VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË ANKESAVE

III

1. Të dhëna të përgjithshme statistikore mbi llojet e ankesave të paraqitura në Komisionin e Prokurimit Publik

Gjatë periudhës 1 janar 2021-31 dhjetor 2021, janë regjistruar pranë Komisionit të Prokurimit Publik 768 ankesa në total, prej të cilave 762 ankesa janë paraqitur për procedurat e prokurimit publik, 3 (tre) ankesa për procedurat e ankandit publik, 2 (dy) ankesa në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe 1 (një) ankesë për procedurat konkurruese leje minerare, të pasqyruara në tabelën e mëposhtme.

Kategorizimi i ankimeve sipas numrit total dhe vlerës së tyre për secilin autoritet kontraktor, llojit të procedurës së prokurimit, si dhe fazës së procesit për të cilin është paraqitur ankimi.

Gjatë vitit 2021, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, janë paraqitur ankesa lidhur me vendimmarrjen për procedurat e prokurimit publik, ankande publike, ankesa në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, si dhe leje minerare për 223 autoritete kontraktore nga 415 të tilla, që kanë krijuar procedura prokurimi në Sistemin e Prokurimeve Elektronike³.

Komisioni i Prokurimit Publik, ka marrë vendime në lidhje me ankesat e paraqitura për procedura të cilat në total, referuar fondit limit të prokuruar, arrijnë një vlerë prej 13,716,561,152 lekë, nga totali prej 149,320,420,249 lekë të publikuara për prokurim, pra 9.2 % e fondit limit total të publikuar për prokurim, është shoqëruar me ankesa në procedurat përkatëse.

Nga 5079 procedura të publikuara për prokurime, (pa përfshirë ankande dhe koncesione), për 566 prej tyre ose për 11.1 % prej tyre, janë paraqitur ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik.

Gjatë vitit 2021, është vënë re një rritje e numrit të ankimeve administrative të paraqitura pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në një total prej 768 ankesash, krahasuar kjo me vitin paraardhës 2020, gjatë të cilit, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, janë dorëzuar 741 ankesa.

³ (2021). *Analiza Vjetore*. Tirana: APP

Duke krahasuar numrin e ankesave të depozituara gjatë viteve 2020-2021, vihet re një rritje me rreth 3.7 % ndaj atyre të vitit 2020. Gjatë vitit 2021, muaji tetor është muaji me numrin më të lartë të ankesave, me 80 ankesa, dhe ai me numrin më të ulët të ankesave është muaji shkurt, me 44 ankesa.

Tabela nr. 6
Ankesat sipas llojit për vitet 2019, 2020, 2021

Nr.	Ankesa të depozituara në KPP	2019	2020	2021
1	Procedurë Prokurimi Publik	1047	732	762
2	Koncesion	0	1	0
3	Ankand	4	3	3
4	Leje Minerare	1	5	1
5	Ankesa në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë	-	-	2
Total		1052	741	768

2. Të dhëna statistikore për numrin total të ankesave sipas fazës për të cilin është paraqitur ankimi

Nga 768 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) ankesa të paraqitura në total, 298 prej tyre ose rreth 38.8 %, janë ankesa të paraqitura për dokumentet e tenderit dhe 470 ankesa ose rreth 61.2 % e tyre, janë ankesa të paraqitura për fazën e vlerësimit të ofertave. Më poshtë po paraqesim dy tabela me pesëmbëdhjetë autoritetet kontraktore, që kanë numrin më të lartë të ankimeve për secilën fazë.

Tabela nr. 7


Nr.	Ankesa të depozituara në KPP	2019	2020	2021
1	Dokumente tenderi	211	216	298
2	Vlerësim	841	525	470
Total		1052	741	768

Autoritetet kontraktore me numrin më të lartë të ankesave të dorëzuara për vitin 2021, fazat për të cilat është paraqitur edhe vendimmarrja e KPP-së.

Tabela nr. 8

Nr.	Autoriteti kontraktor	Faza për të cilin paraqitet ankimi		Pranim		Mospranim		Të mbyllë çështjen/Pranim nga AK		Tërheqje nga ankesa	
		DST	Vlerësim	DST	Vlerësim	DST	Vlerësim	DST	Vlerësim	DST	Vlerësim
1	Agenzia e Blerjeve të Përqendruara	26	51	21	7	3	24	1	6	-	2
2	Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza	34	26	25	7	4	9	2	2	-	-
3	Kesh Sh.A	12	16	7	8	1	7	-	-	-	-
4	Bashkia Durrës	3	13	2	4	1	9	-	-	-	-
5	Sh.A Posta Shqiptare	6	10	4	0	1	7	-	1	1	-
6	Bashkia Elbasan	4	10	4	1	-	9	-	-	-	-
7	Autoriteti Rrugor Shqiptar	-	12	-	1	-	8	-	-	-	2
8	Sh.A Ujësjellës Kanalizime Durrës	7	5	5	2	2	3	-	-	-	-
9	Bashkia Shkodër	6	5	2	0	1	5	2	-	-	-
10	Ministria e Mbrojtjes	2	9	1	5	-	3	-	-	-	-

Shënim: Në tabelë është pasqyruar vendimmarrja e KPP-së deri në 31 Dhjetor 2021. Ankesat për të cilat KPP-ja është shprehur me vendim pas kësaj date, do të pasqyrohen në raportin e vitit 2022...

Grafiku nr. 3
Autoritetet kontraktore me numrin më të lartë të ankesave në formë grafike

Tabela nr. 9
Autoritetet kontraktore me numrin më të lartë të ankesave të dorëzuara për vitin 2021, sipas llojit të kontratës.

Nr.	AUTORITETI KONTRAKTOR	Totali i ankesave	Lloji i kontratës		
			Punë	Mall	Shërbim
1	Agjencia e Blerjeve të Përqendruara	77	-	50	27
2	Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza	60	-	57	3
3	Kesh Sh.A	28	12	6	9
4	Bashkia Durrës	16	6	5	5
5	Sh.A Posta Shqiptare	16	-	10	6
6	Bashkia Elbasan	14	-	11	3
7	Autoriteti Rrugor Shqiptar	12	3	-	9
8	Sh.A Ujësjetës Kanalizime Durrës	12	-	7	5
9	Bashkia Shkodër	11	-	3	6
10	Ministria e Mbrojtjes	11	3	6	2

Numri i ankesave të paraqitura sipas intervalit të fondeve limit pa TVSH

Nga analiza e përgjithshme rezulton, se numri më i lartë i ankesave është paraqitur për procedurat e prokurimit në intervalet e fondeve limite, midis vlerave 1,000,000-5,000,000 lekë, e cila zë 32.03 % të totalit të ankimeve të paraqitura pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ndërkohë që për procedurat me fond limit mbi 100,000,000 lekë, zënë rreth 6.64 % të numrit të ankesave.

Në analizimin e të dhënave statistikore mbi shqyrtimin e ankesave gjatë vitit 2021, referuar 6 intervaleve të fondeve limite të procedurave të prokurimit/ankandëve/lejeve minerare dhe koncesioneve/PPP, shqyrtuar gjatë vitit 2021, pranë Komisionit të Prokurimit Publik konstatohet se:

- 32.03% e ankesave të administruara gjatë vitit në raportim, lidhen me procedurat me fond limit nga 1,000,001 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së, deri në 5,000,000 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së;
- 30.86 % e ankesave të administruara gjatë vitit në raportim, lidhen me procedurat me fond limit nga 10,000,001 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së, deri në 50,000,000 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së;
- 19.27 % e ankesave të administruara gjatë vitit në raportim, lidhen me procedurat me fond limit nga 5,000,001 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së, deri në 10,000,000 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së;
- 8.98% e ankesave të administruara gjatë vitit në raportim, lidhen me procedurat me fond limit nga 50,000,001 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së, deri në 100,000,000 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së;
- 6.64% e ankesave të administruara gjatë vitit në raportim, lidhen me procedurat me fond limit mbi 100,000,000 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së
- 2.21 % e ankesave të administruara gjatë vitit në raportim, lidhen me procedurat me fond limit nga 0 lekë deri në 1,000,000 lekë, pa përfshirë vlerën e TVSH-së;

Në mënyrë të përmblodhur, të dhënat statistikore, duke u mbështetur në fondin limit, garancinë e ofertës, vlerën e investimit ose vlerën e parashikuar të kontratës për çdo rast konkret nga autoritetet kontraktore, paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela nr. 10


Intervalet e fondit limit pa TVSH		Procedurat e prokurimit	
Nga	Deri	Nr. i çështjeve	Në %
Pa fond limit		0	0.00%
0	1,000,000	17	2.21%
1,000,001	5,000,000	246	32.03%
5,000,001	10,000,000	148	19.27%
10,000,001	50,000,000	237	30.86%
50,000,001	100,000,000	69	8.98%
Mbi 100,000,000		51	6.64%
TOTAL		768	100%

3. Të dhëna statistikore për numrin total të ankesave sipas llojit të kontratës për punë, mall, shërbim

Gjatë vitit 2021, numrin më të madh të ankesave, e zënë ato në lidhje me procedurat e prokurimit për kontratat për mallra me 437 të tilla, për kontratat për shërbime me 234 ankesa, duke vijuar me ankesat për kontratat për punë publike me 93 ankesa.


Grafiku nr. 4

Ankesa sipas tipit të kontratës




Të dhëna statistikore mbi shpërndarjen e ankesave sipas qarqeve:

1. Qarku Tiranë / 501 ankesa, 96 AK, 146 OE
2. Qarku Durrës / 54 ankesa, 12 AK, 11 OE
3. Qarku Fier / 44 ankesa, 13 AK, 18 OE
4. Qarku Vlorë / 44 ankesa, 18 AK, 6 OE
5. Qarku Elbasan / 38 ankesa, 10 AK, 10 OE
6. Qarku Shkodër / 32 ankesa, 6 AK, 6 OE
7. Qarku Kukës / 12 ankesa, 3 AK, 2 OE
8. Qarku Korçë / 11 ankesa, 5 AK, 3 OE
9. Qarku Berat / 11 ankesa, 3 AK, 1 OE
10. Qarku Gjirokastrë / 8 ankesa, 3 AK, 3 OE
11. Qarku Dibër / 8 ankesa, 5 AK, 3 OE
12. Qarku Lezhë / 5 ankesa, 2 AK, 2 OE



Grafiku nr. 5


Fluksi i ankesave për çdo muaj



Ankesa të paraqitura sipas ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Gjatë vitit 2021, ashtu siç e kemi përmendur edhe më lart, janë paraqitur në total 768 ankesa, prej të cilave 349 ankesa janë shqyrtuar në përputhje me ligjin nr. 9643 “Për prokurimin publik”, pasi janë procedura, për të cilat urdhri i prokurimit ka dalë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ndërsa 419 ankesa janë shqyrtuar me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Grafiku nr. 6



4. Të dhëna të përgjithshme statistikore mbi vendimmarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik

Në 776 ankesa të paraqitura nga operatorët ekonomikë, të shqyrtuara dhe të zgjidhura nga Komisioni i Prokurimit Publik, janë arritur 676 vendime përfundimtare.

- Nisur nga numri total i ankesave të shqyrtuara pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton, se 426 ankesa ose 54.9 % prej tyre, janë ankesa për kontrata për “mall”.
- Për sa i përket, kontratave për “shërbime”, nga përllogaritjet rezulton, se janë shqyrtuar 250 ankesa ose rreth 32.2 % të ankesave në total, nga të cilat 29 prej tyre janë ankesa për shërbime në fushën e ruajtjes fizike.
- Për sa i përket procedurave për kontrata për “Punë Publike”, nga përllogaritjet rezulton, se janë shqyrtuar 96 ankesa ose 12.4 %, të ankesave në total.

Tabela nr. 11

Ankesa të shqyrtuara Brenda afatit/ankesa të shqyrtuara jashtë afatit gjatë vitit 2021

2021	Ankesat e shqyrtuara	Brenda Afatit	Përqindje(%)	Jashtë Afatit	Përqindje(%)	Totali Ankesave
Tremujori I	Janar - Mars	193	90.2%	21	9.8%	214
Tremujori II	Prill -Qershor	183	88.8%	23	11.2%	206
Tremujori III	Korrik -Shtator	191	88.8%	24	11.2%	215
Tremujori IV	Tetor -Dhjetor	125	88.7%	16	11.3%	141
Totali	Janar - Dhjetor	692	89.2%	84	10.8%	776

Për sa i përket vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik, lidhur me pranimin ose refuzimin e ankesave për ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2019, 2020, 2021, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 12

Viti	Pranuar		Mospranim		Mosmarrje në shqyrtim		Tërheqje nga ankesa		Të mbyllë çështjen ⁴	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
2019	362	34.7%	469	47.5%	139	13.3%	46	4.4%		
2020	354	46.5%	361	47.4%	28	3.7%	18	2.4%		
2021	327	42.1%	343	44.2%	31	4%	21	2.7%	56	7%

Tabela nr. 13

Të dhëna statistikore mbi vendimmarrjet e Komisionit të Prokurimit Publik


Vendime deklarative AK pranon pjesërisht ankesën	Vendime deklarative përfundimtare	Vendime themeli	Vendime për tërheqje nga ankesa
112	54	601	21

⁴ Gjatë vitit 2021 një ndër rrisitë e reja të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në përputhje me nenin 115 pika 3, është që Komisioni i Prokurimit Publik, në rastet e parashikuara në këtë nen nxjerr vendim deklarativ për mbylljen e çështjes.

Grafiku nr. 7:

Vendimmarrja për ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2021

Ankesa të shqyrtuara



Vendim deklarativ (Autoriteti kontraktor pranon pjesërisht ankesën) - Referuar nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas dispozitave ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga marrja e njoftimit të autoritetit entit kontraktor, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Vendim deklarativ për mbylljen e çështjes - Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e njoftimit të vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre.

Në përputhje me nenin 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, do të konsiderohet:

Pranim

- Komisioni i Prokurimit Publik pranon plotësisht apo pjesërisht ankesën dhe urdhëron autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin.

Refuzim

- KPP-ja mund të refuzojë (të mos pranojë) ankesën, për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj.
- KPP-ja mund të refuzojë (të mos pranojë) ankesën, pas shqyrtimit në themel të saj dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon, se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore.

Tërheqje nga ankesa

- Në rast të tërheqjes së ankesës nga operatori ekonomik në përputhje me nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.

Gjatë vitit 2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur mospranimin e 61 ankesave, për shkak se janë dorëzuar jashtë ose para afateve pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoriteteve kontraktore, të cilat referuar numrit total, përbëjnë rreth 7.9 % të ankesave të dorëzuara pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Efektet financiare të vendimmarrjes në ankesat për fazën e vlerësimit - kursimi në buxhetin e shtetit

Gjatë vitit 2021 nga totali i ankesave të shqyrtuara, 483 (katërqind e tetëdhjetë e tre) prej tyre, janë paraqitur për fazën e vlerësimit të ofertave. Pas vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik rezulton, se pas ushtrimit të mjeteve të rishikimit, ankimit administrativ nga operatorët ekonomikë, me anë të dorëzimit të ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik, KPP-ja pas shqyrtimit të ankesave, nga vendimmarrja e kësaj të fundit, i ka kursyer buxhetit të shtetit, vlerën prej rreth 119,346,291 lekë pa TVSH, llogaritur si diferencë e ofertës së kualifikuar nga vendimmarrja e autoriteteve kontraktore dhe e operatorëve ekonomikë të ankuar, ankesa e të cilëve është pranuar nga Komisioni i Prokurimit Publik.

5. SEANCAT DËGJIMORE

Komisioni i Prokurimit Publik, gjatë shqyrtimit të ankesave dhe pretendimeve të ngritura nga operatorët ekonomikë, përpara daljes në një vendimmarrje, me qëllim shqyrtimin sa më të drejtë të ankesës, për një vendimmarrje të drejtë dhe transparente, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”

si dhe neneve 23, 24 dhe 26 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, gjatë vitit 2021 ka zhvilluar seanca dëgjimore, me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të autorizuar të autoritetit kontraktor dhe përfaqësuesit të autorizuar të operatorit ekonomik për 28 (njëzet e tetë) ankesa, 22 (njëzet e dy) prej të cilave, lidhen me pretendimet e ngritura për hartimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit dhe 6 (gjashtë) prej tyre lidhen me kundërshtimin e vlerësimit të ofertës.

6. VENDIMET PËR EKSPERTIZË

Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të ankesave, në rastet kur Komisioni e ka gjykuar të nevojshme, ka realizuar edhe ekspertizë teknike të posaçme, mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të pajisjeve të dorëzuara nga operatorit ekonomik. Gjatë vitit 2021, Komisioni i Prokurimit Publik është shprehur me 9 (nëntë) vendime për ekspertizë të posaçme.

7. VENDIMET INTERPRETUESE

Në mbështetje të nenit 24, pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet, se Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme, gjatë vitit 2021, edhe si rezultat i risive që ka sjellë ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik është shprehur me disa vendime interpretuese si më poshtë vijon:

- **Vendimi KPP 260/2021, datë 03.06.2021**

Në këtë vendim, janë trajtuar çështje me rëndësi, veçanërisht në lidhje me ligjin e zbatueshëm në drejtim të procedurës së ankimit, në periudhën e aplikimit të dispozitave kalimtare të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kundër vendimmarrjes së autoritetit kontraktor për procedurat e prokurimit.

- **Vendimi KPP 274/2021, datë 11.06.2021**

Në këtë vendim, janë trajtuar çështje me rëndësi, veçanërisht mbi kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesave të paraqitura në fazën e dytë të procedurës, kundër vendimmarrjes së autoritetit kontraktor, për procedurat e prokurimit të kryera në përputhje me ligjin nr. 97/2020 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përbalimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

- **Vendimi KPP 305/2021, datë 23.06.2021**

Në këtë vendim, janë trajtuar çështje me rëndësi, veçanërisht në lidhje me ligjin e zbatueshëm në drejtim të procedurës së ankimit, në periudhën e aplikimit të dispozitave kalimtare të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kundër vendimmarrjes së autoritetit kontraktor për procedurat e prokurimit.

- **Vendimi KPP 1047/2021, datë 29.12.2021**

Në këtë vendim, janë trajtuar çështje me rëndësi, veçanërisht në lidhje me të drejtën e operatorit ekonomik, i cili ka marrë pjesë në një procedurë prokurimi dhe mund të cenohet nga ankesa e paraqitur, për të paraqitur argumentet e tij lidhur me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 1 të nenit 131 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”. Mosrespektimi i momentit procedural për paraqitjen e argumenteve nga ana e operatorit ekonomik të interesuar, sjell humbjen e së drejtës së ankimit të parashikuar në mënyrë taksative nga normativa ligjore.

8. Kushtet për pranimin e ankimeve dhe arsyet më të zakonshme për paraqitjen e tyre

Në bazë të parashikimeve të ligjit “Për prokurimin publik” dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore të zbatueshme, Komisioni i Prokurimit Publik vihet në lëvizje vetëm mbi bazë të ankesës.

Për ankesa të paraqitura sipas ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik vendos:

- a) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- b) pranimin e plotë të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës

Me marrjen e ankesës me shkrim, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

- në rastin kur ankesa është pranuar pjesërisht nga autoriteti/enti kontraktor vijon me shqyrtimin për pjesën e ankesës/prendimeve që nuk janë pranuar ,
- shqyrtimin e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar.
- në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, nëse jo do të shprehet me vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 (tri) ditëve.
- në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës, vijon me shqyrtimin në themel të saj.

Në shqyrtimin në themel të ankesave, në varësi të fazës së procedurës së prokurimit për të cilën ato janë paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik, rast pas rasti, ka shqyrtuar ankesa të cilat kanë pasur si objekt respektimin e kërkesave të ligjit dhe akteve nënligjore, të lidhura kryesisht me:

a. Ankesat e paraqitura për dokumentet e tenderit:

- Respektimin e rregullave për përcaktimin e fondit limit sipas fushës që i përket objekti i prokurimit, veçanërisht në rastet kur llogaritja e fondeve limite i referohet manualeve kombëtare.
- Respektimin nga autoritetet kontraktore të kërkesave të ligjit për hartimin e specifikimeve teknike dhe në rregullat përkatëse të prokurimit;
- Respektimin e rregullave për hartimin e kërkesave dhe dokumenteve provuese në lidhje me kriteret e kualifikimit, sipas ligjit dhe në rregullat përkatëse të prokurimit.

- Ruajtjen e zbatimit të parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit, në rastet kur autoritetet kontraktore në hartimin e kërkesave të cilësisë, vendosin kërkesa të tepërta, të panevojshme ose pa lidhje me objektin e prokurimit, për certifikime e akreditime kombëtare ose ndërkombëtare.
- Numrin e lartë të mostrave të kërkuara nga autoritetet kontraktore, veçanërisht në procedurat e prokurimit, me objekt blerjen e materialeve të kancelarisë dhe tonerat.

- **Për vitin 2021, nga 768 ankesa në total, 298 prej tyre, janë ankesa të paraqitura për dokumentet e tenderit.**

Gjithashtu, rezulton, se për dokumentet e tenderit, 195 ankesa janë pranuar plotësisht ose pjesërisht, duke ndryshuar kushtet e garës dhe hapjen e konkurrencës në procedura.

b. Ankesat e paraqitura për fazën e vlerësimit të ofertave:

- Skualifikim i padrejtë, i pabazuar në ligj dhe në rregullat e prokurimit i ankimuesit, nga ana e autoriteteve kontraktore, për mospërmbushje të kriterëve kualifikuese dhe/ose specifikimeve teknike;
- Kualifikim i padrejtë, i pabazuar në ligj dhe në rregullat e prokurimit i ofertuesve të tjerë të ndryshëm, nga ankimuesi, duke u anashkaluar kërkesat e vendosura nga vetë autoritetet kontraktore, për përmbushje të kriterëve kualifikuese dhe/ose specifikimeve teknike;
- Mosrespektimi i rregullave për njoftimet dhe komunikimin me pjesëmarrësit në një procedurë prokurimi;
- Mosrespektimi i afateve dhe procedurave të kualifikimit dhe përzgjedhjes nga autoritetet kontraktore, duke kërkuar anulimin e procedurës.
- Mosrespektimi i procedurës së administrimit dhe verifikimit të mostrave të dorëzuara në procedurat e prokurimit publik.

Për vitin 2021, nga 768 ankesa në total, **470 prej tyre**, janë ankesa të paraqitura për fazën e vlerësimit të ofertave.

9. Problematikat e identifikuara në funksionimin e sistemit të ankimit për prokurimin publik

Komisioni i Prokurimit Publik, vitet e fundit është pozicionuar si organ i shqyrtimit administrativ të procedurave të prokurimit, i pavarur nga pushteti ekzekutiv, ashtu siç kërkojnë standardet bashkëkohore të menaxhimit të financave publike.

Kjo dinamikë zhvillimi, e përball Komisionin e Prokurimit Publik, me sfida të rëndësishme në drejtim të përmirësimit të performancës së tij, të lidhur ngushtë me objektin e tij të aktivitetit, por njëkohësisht, për shkak të hapësirave që Komisioni i Prokurimit Publik ka në identifikimin e fenomeneve problematike në nivel sistemi, krijon dhe mundësinë, që ky institucion të kontribuojë në përmirësimin në tërësi, të sistemit të prokurimit publik.

Vlerësime të përgjithshme:

- Edhe gjatë vitit 2021, rezulton një numër i lartë i ankimeve, që paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik me një kompleksitet të lartë.
- Gjatë vitit 2021, rezulton, se problematika shumëvjeçare e abuzimit të instrumenteve të ankimit administrativ për prokurimet publike nga shoqëritë e ruajtjes dhe sigurisë fizike, gjë që ka shkaktuar një mbingarkesë të theksuar të Komisionit të Prokurimit Publik ndër vite, ka rënë. Në vitin 2021, janë regjistruar vetëm 23 ankesa ose thënë ndryshe 3 % e totalit të ankesave, krahasuar me 12,6 % në vitin paraardhës, për prokurimet në fushën e ruajtjes dhe sigurisë fizike.

Në drejtim të funksionimit të sistemit të ankimit për prokurimin publik, janë identifikuar problematikat në vijim:

Problematikat/gabimet procedurale të konstatuara në ankesat e operatorëve ekonomikë:

Në një numër të konsiderueshëm rastesh është konstatuar, se operatorët ekonomikë nuk janë mjaftueshëm të informuar për formën, afatet dhe procedurat e përcaktuara nga ligji, për ankimin administrativ për prokurimin publik. Kjo sjell në shumë raste, mospranimin e ankesave të paraqitura, vetëm për mosplotësim të kriterëve formale.

Pesë gabimet/problematikat tipike të paraqitjes së ankesës nga operatorët ekonomikë, paraqiten si më poshtë vijon:

1. Gjatë punës së Komisionit të Prokurimit Publik në vitin 2021 është vënë re, se një numër i lartë i operatorëve ekonomikë paraqesin ankesë pranë KPP-së dhe autoritetit kontraktor, përpara se të nisin afatet e ankimit, duke paraqitur ankimin e tyre, që

në momentin që njihen me klasifikimin e ofertave dhe duke mos pritur publikimin e njoftimit të fituesit apo njoftimin e anulimit të procedurës, në rastet kur nuk ka asnjë ofertë të kualifikuar. Në këtë mënyrë, vlerësohet, se operatorët ekonomikë nuk janë njohur plotësisht me risitë e ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

2. Referuar formës së paraqitjes së ankimit, janë konstatuar raste në të cilat, operatorët ekonomikë nuk kanë paraqitur ankimin e tyre sipas formularit standard të ankesës, miratuar sipas dokumenteve të reja të tenderit, por kanë përdorur formularin e vjetër të ankimit sipas dokumenteve të tenderit, të miratuara në mbështetje të Ligjit të vjetër të prokurimit.
3. Operatorë ekonomikë kanë paraqitur ankimin e tyre, pa paraqitur formularin e pagesës, kusht ky i domosdoshëm për vlefshmërinë e ankimit.
4. Operatorët ekonomikë ankimes kanë paraqitur ankimin e tyre, duke përdorur formularin standard të paraqitjes së argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar dhe jo formularin standard të paraqitjes së ankesës.
5. Operatorët ekonomikë, në cilësinë e subjektit të interesuar, të prekur nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor, kanë paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke mos e zaturuar shkallën e paraqitjes së argumenteve pranë autoriteteve kontraktore dhe KPP-së, sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 113.

Problematikat/gabimet procedurale të konstatuara në veprimet e autoriteteve kontraktore:

Në një numër të konsiderueshëm rastesh është konstatuar, se autoritetet kontraktore nuk janë mjaftueshëm të informuara për ndryshimet e ligjit të prokurimit publik, veçanërisht në drejtim të procedurës së ankimit. Pesë gabimet/problematikat tipike të autoriteteve kontraktore paraqiten si më poshtë vijon:

1. Mosnjohja e mirë e ndryshimeve të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimet publike” nga ana e autoriteteve kontraktore, veçanërisht mbi momentin procedural të fillimit të afateve të ankimit.
2. Moskryerja e veprimeve procedurale të ngarkuara nga ligji, për komunikimin midis autoritetit kontraktor dhe operatorëve ekonomikë, për korrigjimin e të metave të ankesës.
3. Moskryerja e veprimeve procedurale të parashikuara nga neni 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nga ana e autoriteteve kontraktore për njoftimin e vendimmarrjes mbi trajtimin e ankesës, jo vetëm operatorëve ekonomikë ankimes, por edhe subjekteve të interesuara që preken nga vendimi, si dhe Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Mosrespektimi i periudhës së pritjes në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, në rastet e paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

5. Mosdorëzimi në kohë dhe i plotë i informacionit të kërkuar nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe moszbatimi në kohë i vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik.

Masat e marra dhe propozime për përmirësimin e tyre:

1. Nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, janë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për informimin e operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve kontraktore, mbi momentin procedural të fillimit të afateve të ankimit, si me anë të publikimit në faqen zyrtare të procedurave të ankimit referuar ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ashtu edhe me publikimin e njoftimit, për marrjen e vendimeve interpretuese në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, sqaruar në detaje edhe në këtë raport.
2. Gjithashtu, në vitin 2021, Komisioni i Prokurimit Publik zhvilloi një konferencë të përbashkët me operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore, mbi problematikat e konstatuara në sistemin e prokurimeve dhe përmirësimin e tyre.
3. Gjatë vitit 2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka hartuar në mënyrë periodike buletine mujore të veprimtarisë, në të cilat ka pasqyruar edhe problematikat e konstatuara në vendimmarrje.

Propozohet nxitja e trajnimeve, si për zyrtarët e prokurimit publik edhe për punonjësit e operatorëve ekonomikë. Një kurrikul e posaçme trajnimi dhe një nivel certifikimi specifik për zyrtarët e prokurimit, njësinë/zyrtarin e prokurimit, komisionin e vlerësimit të ofertave/zyrtarin e vlerësimit të ofertave, si edhe menaxherin e kontratave publike, vlerësojmë, se do të sillte ndikim të rëndësishëm në sistemin e prokurimit.

Propozime për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik përmes ndryshimeve ligjore

Për ndryshimet në Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

Gjatë vitit 2021, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, janë paraqitur 419 ankesa referuar ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Gjatë punës të përditshme të Komisionit të Prokurimit Publik, janë konstatuar disa çështje, ndaj propozojmë ndryshimin e këtyre neneve, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të legjislacionit për prokurimin publik.

Propozojmë ndryshime të nenit 109 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, duke shtuar të drejtën për të vënë në lëvizje Komisionin e Prokurimit Publik (rregullimin e interesit të ligjshëm-legjitimimin substancial (*ad causam*).

Gjithashtu, lidhur me përcaktimet e pikës 2 të nenit 115 të ligjit nr.162/2020, kemi konstatuar, se marrja e një vendimi deklarativ për pjesën e pranuar nga autoriteti kontraktor dhe vijimi i shqyrtimit për pjesën tjetër të ankesës, në rastet kur autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht ankesën, nuk kanë asnjë ndikim në procedurat e prokurimit, pasi përsëri procedura e prokurimit mbetet e pezulluar deri në një vendim përfundimtar. Gjykojmë, se një akt i tillë administrativ nuk sjell asnjë efekt në procedurat e shqyrtimit administrativ, përkundrazi ngarkon në mënyrë të panevojshme anëtarët dhe stafin e Komisionit të Prokurimit Publik. Për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës dhe vijimin për pjesën tjetër të saj, Komisioni i Prokurimit Publik mund të shprehet edhe në vendimin përfundimtar.

Sa më sipër, propozojmë shfuqizimin e pikës 2 të nenit 115 të ligjit nr.162/2020.

Mbi nevojën e hartimit të standardeve kombëtare

Gjatë vitit 2021, është konstatuar një numër i lartë i ankesave në procedurat e prokurimit publik, në lidhje me dokumentet e procedurave të prokurimit. Disa prej këtyre ankesave lidhen gjithashtu edhe me mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike për procedura specifike.

Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, KPP-ja gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike në një procedurë prokurimi. Një prej tyre mbështetet në **standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare**, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit.

Gjatë vitit 2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka konstatuar një numër të ulët ankesash në drejtim të mallrave, ku specifikimet teknike rregullohen me standard kombëtar në fuqi, si në rastin e grupmallrave për të cilat Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka hartuar standardet kombëtare në përputhje me Vendimin Nr. 673, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Riorganizimin E Agjencisë Kombëtare Të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

Propozojmë nxitjen e hartimit të Standardeve Kombëtare (S SH) për grup mallrash me përdorim të përgjithshëm, të cilat do të ndikojnë në sistem, në drejtim të mënyrës së hartimeve të specifikimeve teknike nga ana e autoriteteve kontraktore.

10. MONITORIMI I ZBATIMIT TË VENDIMEVE DHE MASAT NDËSHKUESE

Rezulton, se gjatë vitit 2021, Komisioni i Prokurimit Publik gjatë vendimmarrjes së tij ka konstatuar shkelje në procedurat e prokurimit publik nga ana e autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë për 11 (njëmbëdhjetë) çështje, të cilat i janë referuar për hetim administrativ Agjencisë së Prokurimit Publik.

Nga hetimi i thelluar për 11 çështjet e referuara, Agjencia e Prokurimit Publik, për 4 prej tyre ka vendosur përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimeve publike.

Gjithashtu, rezulton, se për 3 (tri) çështje, KPP-ja referuar pranë Autoritetit të Konkurrencës, është shprehur me vendimin Nr.796 datë 29.04.202, ku për dy prej tyre, ky autoritet ka vendosur t'u tërheqë vëmendjen operatorëve ekonomikë për zbatimin e angazhimeve të depozituara gjatë pjesëmarrjes së tyre në të gjitha procedurat e prokurimit, ku ato ofertojnë në kuadër të objektit të veprimtarisë së tyre.

Krahas çështjeve të dërguara për hetim administrativ pranë Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur masë administrative gjombë ndaj 3 (tre) titullarëve të autoriteteve kontraktore, si rezultat i refuzimit për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik.

Tabela nr. 14

Rezultatet e hetimit administrativ të Agjencisë së Prokurimit Publik për rastet e referuara nga Komisioni i Prokurimit Publik

Nr.	Vendime të KPP-së të dërguara për hetim administrativ APP-së gjatë 2021	Statusi		
		Në proces	Pushuar	Vendimmarrje
1	KPP 16/2021	+		
2	KPP 20/2021	+		
3	KPP 58/2021		+	
4	KPP 159/2021		+	
5	KPP 263/2021			Përjashtuar Operatorë ekonomikë
6	KPP 264/2021			Përjashtuar Operatorë ekonomikë
7	KPP 672/2021		+	
8	KPP 698/2021		+	
9	KPP 985/2021		+	
10	KPP 40/2021			Përjashtuar Operatorë ekonomikë
11	KPP 41/2021			Përjashtuar Operatorë ekonomikë

Tabela nr. 15

Rezultatet e hetimit të Autoritetit të Konkurrencës për rastet e referuara nga Komisioni i Prokurimit Publik

Nr.	Vendime të KPP-së të dërguara për hetim administrativ Autoritetit të konkurrencës gjatë 2021	Statusi	
		Pushuar	Vendimmarrje
1	Vendimi Nr.209/4		Me Vendimin Nr.796 datë 29.04.2021- Miratimin e angazhimeve të depozituara nga OE gjatë pjesëmarrjes së tyre në të gjitha procedurat e prokurimit ku ato ofertojnë në kuadër të objektit të veprimtarisë së tyre
2	Vendimi Nr.228/5		Me Vendimin Nr.796 datë 29.04.2021- Miratimin e angazhimeve të depozituara nga OE gjatë pjesëmarrjes së tyre në të gjitha procedurat e prokurimit ku ato ofertojnë në kuadër të objektit të veprimtarisë së tyre
3	Vendimi KPP 228/2021	+	

Tabela nr. 16
Vendimet administrative, ku Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur marrjen e masës administrative gjorbë:

Nr.	Vendimi KPP	Masë administrative gjorbë
1	KPP 375/2021	50,000
2	KPP 756/2021	250,000
3	KPP 967/2021	50,000

Monitorimi i zbatimit të vendimeve

Në zbatim të ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik", vendimet e marra nga Komisioni Prokurimit Publik janë administrativisht përfundimtare. Ligji nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në nenin 131 të tij parashikon shprehimisht: "Refuzimi i autoritetit kontraktor për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik, Agjencinë e Prokurimit Publik, ngarkon me përgjegjësi titullarin e autoritetit kontraktor dhe dënohet nga këto institucione me gjorbë". Është kjo dispozitë, e cila qartëson fuqinë detyruese të vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik, si administrativisht përfundimtare.

Zbatimi në kohë i vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik, lidhet drejtpërdrejtë me elementet e një procesi të rregullt ligjor për palët në proces, si edhe nga ana tjetër, mbron interesin më të lartë publik, për marrjen në kohë të punë/mallra/shërbime dhe shmangien e përdorimit të procedurave me negociim. Struktura e posaçme e monitorimit dhe e verifikimit të zbatimit të vendimeve të KPP-së, ka vijuar me monitorimin e zbatimit të vendimeve të KPP-së edhe gjatë vitit 2021. Falë kësaj strukture, gjatë vitit 2021 vihet re,

se është rritur ndjeshëm zbatimi në kohë i vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.

Nga monitorimi i kryer për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka shqyrtuar në total 776 ankesa, nga të cilat, për 327 ankesa, pas shqyrtimit administrativ të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik, ka vendosur, që autoriteti kontraktor të bëjë modifikimet të specifikuar në vendim.

Gjatë vitit 2021, Komisioni i Prokurimit Publik, pas tejkalimit të afatit ligjor të përcaktuar për zbatimin e vendimeve nga ana e autoritetit kontraktor, ka dërguar 60 (gjashtëdhjetë) kërkesa drejtuar autoriteteve kontraktore për zbatim vendimi, për të cilat autoritetet kontraktore kanë sjellë informacion duke dokumentuar veprimet e kryera brenda një mesatareje prej 6 (gjashtë) ditësh nga dërgimi i kërkesës për zbatim vendimi.

11. Proceset gjyqësore lidhur me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për periudhën janar 2021-dhjetor 2021

Si organi më i lartë administrativ në fushën e shqyrtimit të ankesave për procedurat e prokurimit publik, vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik është administrativisht përfundimtar. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", palëve të prekura nga vendimmarrja e Komisionit të Prokurimit Publik, ju është dhënë e drejta e ankimit drejtpërdrejt në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila ushtron juridiksion fillestar.

Numri total i vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2021, (ku përfshihen vendimet deklarative përfundimtare, vendimet e themelit dhe vendimet për tërheqjen nga ankesa), është 676. Referuar numrit total të këtyre vendimeve, për vetëm për 53 prej tyre, subjektet e prekura nga vendimmarrja e Komisionit të Prokurimit Publik kanë ngritur padi në gjykatë, që përbëjnë vetëm 7.8% të numrit total të vendimeve.

Nga 53 padi të ngritura, 38 padi janë ngritur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe 15 padi janë ngritur në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila në zbatim të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", tashmë i shqyrton paditë e ngritura kundër vendimeve të KPP-së me juridiksion fillestar.

Nga 53 padi të ngritura, në 4 raste paditësi është autoritet kontraktor, ndërsa në 49 raste paditësi është operator ekonomik. Në 4 prej rasteve, është ankimuar i njëjti vendim i KPP-së, nga 2 paditës të ndryshëm (pra, 8 paditës për 4 vendime të KPP-së). Në 2 raste, i njëjti paditës ka ankimuar 2 vendime të KPP-së (pra, 2 paditës për 4 vendime të KPP-së).

Në përfundim të procesit gjyqësor në shkallë të parë dhe në apel, gjykata ka vendosur pranimin e 6 kërkesëpadive, ka vendosur rrëzimin e 23 kërkesëpadive, ndërsa 24 kërkesëpadi të tjera, janë ende në proces shqyrtimi gjyqësor, në shkallë të parë dhe në apel.

Në analizë të proceseve gjyqësore, referuar vendimeve të gjykuara të përfunduara në shkallën e parë dhe në apel, vërehet se Gjykata Administrative, ka mbajtur të njëjtin qëndrim me Komisionin e Prokurimit Publik në 43.4% të çështjeve të përfunduara dhe ka shfuqizuar vendimmarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik vetëm në 11.3% të çështjeve të përfunduara.

Duke mbajtur në konsideratë, se deri në datën e dorëzimit të këtij raporti, janë në proces gjyqësor edhe 24 çështje, vendimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës Administrative të Apelit, që kanë lënë në fuqi vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik, janë dukshëm më të larta në numër, në krahasim me vendimet e shfuqizuara.

Nga 29 vendimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, vetëm 14 prej tyre janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit, ndërkohë që 9 vendime kanë marrë formë të prerë. Kjo tregon, se paditësi ka pranuar vendimmarrjen e Gjykatës Administrative, duke u bindur për ligjshmërinë e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik.

Pasqyra e të dhënave të çështjeve gjyqësore, nxjerr në pah faktin, se Komisioni i Prokurimit Publik është një organ, i cili ka krijuar qëndrueshmëri në vendimmarrje dhe gjithashtu tregon për një konsolidim të qëndrimeve, qoftë të Komisionit të Prokurimit Publik, qoftë të gjykatave për raste të ngjashme. Ky konkluzion, arrihet jo vetëm për shkak të përqindjes së lartë të konfirmimit nga gjykata të kësaj vendimmarrjeje në krahasim me vendimet e shfuqizuara, por edhe duke vlerësuar numrin e ulët të kërkesëpadive, në krahasim me vendimet e marra nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në Tabelën 17 më poshtë, paraqiten të dhënat e lidhura me proceset gjyqësore të filluara kundër vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik gjatë viteve 2020 - 2021.

Tabela nr. 17
Proceset gjyqësore janar - dhjetor 2020 dhe janar - dhjetor 2021

	2020	2021
Totali i vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik	601	676
Ankimuar në gjykatë	59	53
Pranuar padia	17	6
Rrëzuar padia	45	23
Në proces në Gjyk. Shk. I	1	11
Në proces në Gjykatën e Apelit	14	27*
Në Gjykatën e Lartë	-	-

*Shënim**

Kjo shifër i referohet si vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë të ankimuara në Gj.Adm. të Apelit, ashtu edhe vendimeve, ku Gjykata Administrative e Apelit ushtron juridiksion fillestar (sipas parashikimeve të ligjit nr. 162/2020).

Pasqyra e të dhënave të çështjeve gjyqësore, nxjerr në pah faktin, se Komisioni i Prokurimit Publik është një organ i cili ka krijuar qëndrueshmëri në vendimmarrje, duke treguar për një konsolidim të qëndrimeve, qoftë të Komisionit të Prokurimit Publik, të cilat kanë sjellë qëndrueshmëri edhe në vendimet e Gjykatës Administrative për çështje të ngjashme. Ky konkluzion, arrihet jo vetëm për shkak të përqindjes së lartë të konfirmimit nga gjykata të kësaj vendimmarrjeje në krahasim me vendimet e shfuqizuara, por edhe duke vlerësuar numrin e ulët të kërkesëpadive në krahasim me vendimet e marra nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Qëndrueshmëria e gjykatave, në konfirmimin e vendimmarrjeve të Komisionit të Prokurimit Publik, ka ndihmuar mjaft edhe në konsolidimin e praktikës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik për mbajtjen e qëndrimeve të njëjta, në raste të ngjashme apo të njëjta, që i paraqiten për shqyrtim.

Në nivel krahasimor, numri i padive të ngritura në gjykatë gjatë vitit 2021, është më i ulët se numri i padive të ngritura gjatë vitit 2020, ndërkohë që numri i vendimeve të KPP-së është më i lartë gjatë vitit 2021. Përqindja e padive të ngritura në gjykatë për vendimmarrjet e vitit 2020 është 9.8%, ndërsa për vitin 2021 është 7.8%, pra 2% më e ulët.

Tabela nr. 18

	2020	2021
Totali i vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik	601	676
Ankimuar në gjykatë	59	53
Krahasimi i numrit të padive të viteve 2020-2021 në përqindje	9.8%	7.8%

12. E drejta për informim

E drejta për informim përbën një nga të drejtat themelore të qytetarëve, që garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë është rregulluar nga ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Ky ligj i mundëson qytetarëve të marrin informacionin e nevojshëm ndaj çdo autoriteti publik.

Në kuadër të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, Komisioni i Prokurimit Publik mban dhe bën publik Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacioni i dhënë në bazë të kërkesave.

Gjatë vitit 2021, janë paraqitur 11 kërkesa për informim, të cilave Komisioni i Prokurimit Publik, iu ka dhënë përgjigje brenda afatit të përcaktuar në ligj. Koordinatorin për të drejtën e informimit, mban një komunikim të vazhdueshëm me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të programit të transparencës. Lidhur me informacionet që iu janë dhënë subjekteve që kanë kërkuar informacion, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, për vitin 2021, nuk ka pasur asnjë ankim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në aspektin krahasimor, referuar 2 viteve paraardhëse 2019 dhe 2020, numri i kërkesave për informim ka pësuar një rritje, por që mbetet në nivele të ulëta. Kjo për arsye, se Komisioni i Prokurimit Publik, pasqyron në kohë reale veprimtarinë e tij administrative, nëpërmjet publikimit të të dhënave bazuar në parimet open data. Në këtë mënyrë, Komisioni i Prokurimit Publik, i mundëson publikut dhe subjekteve të interesuara, të aksesojnë lehtësisht të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me ankesat apo vendimmarrjet e Komisionit të Prokurimit Publik në faqen e tij zyrtare.

PERFORMANCA FINANCIARE

1. Realizimi i buxhetit të Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2021

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar, si edhe ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, procesi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të vitit 2021, si dhe situata buxhetore me treguesit e realizimit të buxhetit të institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik, për periudhën janar-dhjetor 2021, paraqitet si vijon:

Shpenzimet e përgjithshme, bazuar në buxhetin e vitit 2021 (përfshirë të gjithë zërat e buxhetit 600-601, 602-606, 231), në fund të vitit, kanë arritur në vlerën 58,375.1 mijë lekë, nga 71,150.0 mijë lekë të parashikuara në buxhetin e miratuar për vitin 2021, duke u realizuar në masën 82.04% të planit vjetor ose me një mosrealizim prej afërsisht 12,774.9 mijë lekë ose 17.96%.

Tabela nr. 19

Titulli	Emërtimi	Buxheti i vitit 2021 (në mijë lekë)	Realizimi për vitin 2021	
			në mijë lekë	në %
90	Komisioni i Prokurimit Publik	71,150.0	58,375.1	82.04%
01110	Shërbimi i Prokurimit Publik			

Shpenzimet korrente në fund të vitit, kanë arritur në shumën 57,416.3 mijë lekë ose rreth 81,84 % e buxhetit të planifikuar për vitin 2021, duke rezultuar me një mosrealizim prej afërsisht 12,733.7 mijë lekë, ose 18.16%.

- Artikulli 600, “Paga”, i cili është artikulli i parë, rezulton, se është shfrytëzuar në vlerën 38,927.9 mijë lekë, nga 45,494.8 mijë lekë të parashikuara në buxhetin e vitit 2021, pra realizuar afërsisht 85.56%.

Pra, kemi një përdorim të fondit të pagave në masën afërsisht 85.56%, duke rezultuar me një mosrealizim fondesh në masën e 14.44%.

- Artikulli 601, “Kontribute për Sigurime Shoqërore e Shëndetësore”, rezulton me një realizim në vlerën 5,658.2 mijë lekë, nga 9,600.0 mijë lekë të parashikuara në buxhetin e vitit 2021, pra realizuar afërsisht 58.93%, duke rezultuar me një mosrealizim fondesh prej 41.07%.

- Artikulli 602, përkatësisht “Shpenzime për mallra e shërbime”, rezulton me një realizim vjetor në vlerën 10,749.9 mijë lekë nga 12,750.0 mijë lekë të parashikuara në buxhetin e vitit 2021 për institucionin tonë, ose afërsisht me 84.31 % të planit vjetor, duke rezultuar me një mosrealizim fondesh prej 15.69%.
- Artikulli 606, përkatësisht “Transferta për buxhete familjare dhe individë”, rezulton me një realizim vjetor në vlerën 2,080.3 mijë lekë nga 2,305.3 mijë lekë të parashikuara si fond i veçantë në buxhetin e vitit 2021, ose afërsisht me 90.24 % të planit vjetor, duke rezultuar me një mosrealizim fondesh prej 9.76%.

Shpenzimet kapitale deri në fund të vitit, janë realizuar në masën 958,8 mijë ose rreth 95.88% e planit vjetor, duke rezultuar me një mosrealizim fondesh prej afërsisht 41.2 mijë lekë ose 4.12%.

Gjatë vitit 2021, është vënë re një rritje e numrit të ankimeve administrative të paraqitura pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në një total prej 768 ankesash, krahasuar kjome vitin paraardhës 2020, gjatë të cilit, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, janë dorëzuar 741 ankesa.

2. Parashtrime mbi mjaftueshmërinë e fondeve

Bazuar në treguesit e Tabelës 2 si më poshtë, mund të konstatojmë, se situata ekonomike gjatë vitit 2021, për Komisionin e Prokurimit Publik, ka qenë mëse e qëndrueshme dhe në nivele deri diku optimale. Duke marrë parasysh edhe rrethanat specifike dhe mjaft të vështira e sfiduese të ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik, në kushtet e kufizimeve për shkak të vazhimit të përhapjes së pandemisë dhe ndryshimeve të rëndësishme ligjore të ndodhura në ligjin për prokurimin publik dhe aktet e tjera nënligjore, e cila ka përbërë një risi dhe njëkohësisht sfidë për Komisionin e Prokurimit Publik, vihet re, se ka një mosrealizim të fondeve totale në masën 12,774.9 lekë ose 17.95%. Këto ndryshime u shoqëruan deri diku me vonesa eventuale në ezaurimin total të fondeve dhe zhvillimin e procedurave të ndryshme të prokurimit, të parashikuara dhe planifikuara për plotësimin e nevojave dhe kërkesave të institucionit. Megjithatë, pothuajse, të gjithë zërat e buxhetit janë realizuar brenda masës së planifikuar në Projektbuxhetin Afatmesëm 2021-2023, duke mos e rënduar buxhetin e Shtetit me kërkesa për

alokimin e fondeve shtesë. Masa më e madhe e mosrealizimit konstatohet tek shpenzimet korrente për paga dhe rrjedhimisht për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, për shkak të mosplotësimit të vakancave në strukturë.

Arsyet e mosrealizimit të fondeve buxhetore të planifikuara për shpenzimet e personelit, lidhen me mosplotësimin e vendeve vakante të miratuara në strukturë, me Vendimin nr.65, datë 29.10.2020 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionit të Prokurimit Publik”, për shkak të përfundimit pa fitues të procedurave të rekrutimit të shpallura nga KPP-ja gjatë vitit 2021, kohëzgjatjes së procedurave të rekrutimit, si dhe për shkak të largimeve rishtazi me dorëheqje të disa prej punonjësve të institucionit, situatë e cila ka ndikuar në krijimin dhe rritjen e paplanifikuar të pozicioneve vakante të punës.

Pavarësisht këtij fakti, institucioni ka kryer shpenzimet operative dhe projektet investuese më të rëndësishme të planifikuara në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2021 dhe të domosdoshme për mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij, duke i përdorur dhe shfrytëzuar me efikasitet fondet dhe duke bërë që edhe puna të vijojë me efektshmëri, me qëllim plotësimin e të gjitha nevojave të punonjësve për krijimin e një mjedisi sa më të përshtatshëm pune.

Pra, duke bërë një përmbledhje mbi mjaftueshmërinë e përdorimit të fondeve për vitin 2021, nga Komisioni i Prokurimit Publik, për të gjithë zërat e buxhetit, situata paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela nr. 20

Artikulli	Emërtimi	Buxheti i vitit 2021 (në mijë lekë)	Realizimi për vitin 2021	
			në mijë lekë	në %
600	Paga	45,494.80	38,927.9	85.56%
601	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	9,600.00	5,658.2	58.93%
602	Mallra e shërbime të tjera	12,750.00	10,749.9	84.31%
606	Transferta për buxhete familjare dhe individët	2,305.20	2,080.30	90.24%
600-606	TOTAL Shpenzime korrente	70,150.00	57,416.3	81.84%
231	Shpenzime kapitale	1,000.00	958.8	95.88%
231	TOTAL Shpenzime kapitale	1,000.00	958.8	95.88%
	TOTAL BUXHET	71,150.00	58,375.1	82.04%

3. Të ardhurat jashtëbuxhetore për vitin 2021

Tregues mbi të ardhurat jashtëbuxhetore

Ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik bëhen kundrejt pagesës, parashikuar në nenin 111, pika 2, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Rregullat dhe tarifave të pagesës, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave si vijon:

- Vendimi nr.261 datë 17.03.2010 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifës dhe rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, akt nënligjor i cili rregullon procedurat dhe tarifave për ankesat në procedurat e prokurimit publik;
- Vendimi nr.401, datë 13.05.2015 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj në një procedurë prokurimi të koncesionit/partneritetit publik privat, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, akt nënligjor i cili rregullon procedurat dhe tarifave për ankesat në procedurat e koncesionit/partneritetit publik privat;
- Vendimi nr.56, datë 19.01.2011 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj në një procedurë ankimi ndaj procedurave të ankandit publik apo vendimeve për përjashtim nga to, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, akt nënligjor i cili rregullon procedurat dhe tarifave për ankesat në procedurat e ankandit publik;

Si edhe: Vendimi nr.301, datë 20.4.2016 i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 320, datë 21.4.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e Lejeve Minerare në Zonat Konkurruese”, akt nënligjor i cili rregullon procedurat dhe tarifave për ankesat në procedurat konkurruese të lejeve minerare.

Në zbatim të parashikimeve të akteve ligjore të lartpërmendura, në rastet kur në fund të procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës, ankimi i një operatori ekonomik është pranuar, vlera e tarifës financiare së paguar i kthehet ankimesit, ndërsa në rastet kur në fund të procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës, ankimi i një operatori ekonomik nuk pranohet, vlera e tarifës financiare (e ardhura e arkëtuar nga tarifa e ankimit si garanci për procedura prokurimi) derdhet 100 % në Buxhetin e Shtetit.

Në total, e detajuar sipas Tabelës 3, e cila përmban vetëm shumën e tarifave të paguara dhe të arkëtuara gjatë vitit 2021, për vendime të marra nga Komisioni i Prokurimit Publik gjatë vitit 2021 deri në datën 25 shkurt 2022, rezultojnë, se shuma prej 92,605,847 lekë është kthyer operatorëve ekonomikë ankimes, të cilëve u është pranuar ankesa, ndërsa gjatë vitit 2021, shuma prej 288,475,322.31 lekë, që rezultojnë nga vendimet e marra jo në favor të ankimesve për periudhën 2018-2021, pra të cilëve nuk ju është pranuar ankesa nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. ka kaluar në buxhetin e shtetit.

Shuma e derdhur në Buxhetin e Shtetit nga tarifave të arkëtuara gjatë vitit 2021 është në vlerën prej 40,288,981 lekë, kurse diferenca i përket tarifave të trashëguara nga vitet e kaluara, arkëtuar gjatë periudhës 2018-2020 në vlerën totale prej 248,186,341.31 lekë, sipas detajimeve në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 21

TARIFA FINANCIARE TË DERRDHURA NË BUXHET TË SHETIT	
Viti	Shuma në lekë
2018	74,716,313.31
2019	93,359,226.00
2020	80,110,802
2021	40,288,981
TOTAL	288,475,322.31

Sipas evidencave, rezultojnë, se nga ankesat e depozituara në Komisionin e Prokurimit Publik gjatë vitit 2021, deri në datën 21 shkurt 2021, për 6 prej tyre, Komisioni i Prokurimit Publik nuk ka dalë akoma në një vendimarrje përfundimtare. Shuma totale e tarifave financiare të paguara për këto ankesa, të cilat janë ende në proces shqyrtimi administrativ, arrijnë vlerën prej 1,076,111 lekë.

Sipas rakordimit vjetor të kryer me Degën e Thesarit Tiranë, konstatohen 6 pagesa të depozituara tepër nga operatorë ekonomikë. Për 5 prej tyre rezultojnë, se operatorët ekonomikë ankimes kanë kërkuar faturën për arkëtim, por nga rakordimi i të dhënave dhe konfirmimi nga struktura e protokollit dhe IT-së së institucionit, nuk është regjistruar në Regjistrin e Ankesave dhe nuk është depozituar pranë protokollit asnjë dosje ankese. Këto pagesa shënojnë vlerën prej 204,292 lekë.

Theksojmë, se për vendimet e marra për ankesat e vitit 2021, për të cilat është vendosur pranimi i ankesës së operatorëve ekonomikë, por pavarësisht njoftimeve të kryera nga ana e institucionit për dërgimin e IBAN dhe vërtetimit numër llogarie, ende nuk është dërguar dokumenti bankar nga ana e OE me qëllim plotësimin e praktikës, rezultojnë të mbartura dhe në pritje për rimbursim, të ardhura jashtëbuxhetore nga tarifat financiare, në vlerën prej 3,678,148 lekë. Rrjedhimisht, tarifat financiare të paguara nga këta operatorë ekonomikë do të rimbursohen, në vazhdim gjatë vitit 2022.

Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjatë vitit 2021, ka realizuar në total 146,130,179 lekë, si të ardhura jashtëbuxhetore nga parapagimi i tarifave financiare të operatorëve ekonomikë ankimues pranë KPP-së.

Tabela nr. 22

TË ARDHURA JASHTËBUXHETORE PËR VITIN 2021		
	Totali i të ardhurave viti 2021	
	Në lekë	Në %
Të kthyera ankimuesve për ankesat e pranuar	92,605,847	63.37%
Derdhur në buxhet të shtetit gjatë vitit 2021, për ankesat e papranuara	40,288,981	27.57%
Për t'u derdhur në buxhet të shtetit gjatë vitit 2022, për ankesat e papranuara	4,855,006	3.32%
Tarifa për t'ju kthyer OE nga vendimet e marra gjatë vitit 2021 dhe 2022 (në proces)	3,421,794	2.34%
Vendime për të cilat nuk ka akoma vendimmarrje nga KPP (në total 6 ankesa)	1,076,111	0.74%
Vendime të dala në 2021, por të pakthyera tarifat për mungese IBAN nga OE	3,678,148	2.52%
Pagesa arkëtuar tepër nga OE për të cilët nuk ka dosje	204,292	0.14%
TOTAL të ardhura të arkëtuara gjatë 2021	146,130,179	100.00%

Bazuar në analizën e të dhënave statistikore, rezulton, se 145,344,452 lekë nga totali i të ardhurave jashtëbuxhetore ose 99.46% e të ardhurave, janë nga tarifat e mbledhura për ankesat për procedurat e prokurimit publik; vijuar me 585,727 lekë ose 0.40% e të ardhurave nga tarifat e mbledhura për ankesat për procedurat e ankandeve publike dhe 200,000 lekë ose 0.14% e të ardhurave nga tarifat e mbledhura, për ankesat për procedurat e lejeve minerare.

Tabela nr. 23

Përmbledhëse e procedurave sipas objektit të ankesave				
	Çështje me pagesë		Shuma e pagesës	
	Numri	%	Shuma në lekë	%
Procedurë prokurimi publik	752	99.46%	145,344,452	99.46%
Procedurë koncesioni	0	0.00%	0	0%
Procedurë ankandi	3	0.40%	585,727	0.40%
Procedurë leje minerare	1	0.14%	200,000	0.14%
TOTAL	756	100.00%	146,130,179	100.00%

Krahasim, realizimi i buxhetit 2021 kundrejt buxhetit të vitit 2020
Tabela nr. 24

Artikulli	Emërtimi	Buxheti i vitit 2021 (në mijë lekë)	Realizimi për vitin 2021		Buxheti i vitit 2020 (në mijë lekë)	Realizimi për vitin 2020	
			në mijë lekë	në %		në mijë lekë	në %
600	Paga	45,494.80	38,927.90	85.56%	44,500.00	31,866.10	71.60%
601	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	9,600.00	5,658.20	58.93%	8,600.00	4,255.50	49.50%
602	Mallra e shërbime të tjera	12,750.00	10,749.90	84.31%	8,900.00	4,693.00	52.70%
606	Transferta për buxhetet familjare dhe individët	2,305.20	2,080.30	90.24%	150	0	0.00%
600-606	TOTAL Shpenzime korrente	70,150.00	57,416.30	81.84%	62,150.00	40,814.60	65.70%
231	Shpenzime kapitale	1,000.00	958.8	95.88%	1,000.00	373.2	37.30%
231	TOTAL Shpenzime kapitale	1,000.00	958.8	95.88%	1,000.00	373.2	37.30%
	TOTAL BUXHET	71,150.00	58,375.10	82.04%	63,150.00	41,187.80	65.20%

Tabela nr. 25

Artikulli	Emërtimi	Realizim buxheti për vitin 2021	Realizim buxheti për vitin 2020	Tregues pozitiv i realizimit të buxhetit viti 2021 kundrejt vitit 2020
		në %	në %	në %
600	Paga	85.56%	71.60%	13.96%
601	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	58.93%	49.50%	9.43%
602	Mallra e shërbime të tjera	84.31%	52.70%	31.61%
606	Transferta për buxhetet familjare dhe individët	90.24%	0.00%	90.24%
600-606	TOTAL Shpenzime korrente	81.84%	65.70%	16.14%
231	Shpenzime kapitale	95.88%	37.30%	58.58%
231	TOTAL Shpenzime kapitale	95.88%	37.30%	58.58%
	TOTAL BUXHET	82.04%	65.20%	16.84%

Shpenzimet korrente totale (600-606) në fund të vitit 2021, janë realizuar në masën 16.14% më shumë, krahasuar me shpenzimet korrente të vitit 2020.

- Artikulli 600, "Paga", i cili është artikulli i parë, në vitin 2021, rezulton, se është shfrytëzuar efektivisht në masën 13.96% më shumë krahasuar me vitin 2020.
- Artikulli 601, përkatësisht "Kontribute për Sigurime Shoqërore e Shëndetësore", gjatë vitit 2021, rezulton me një realizim në masën 9.43% më shumë, krahasuar me vitin 2020.
- Artikulli 602, përkatësisht "Shpenzime për mallra e shërbime", gjatë vitit 2021, rezulton me një realizim në masën 31.61% më shumë, krahasuar me vitin 2020.
- Artikulli 606, përkatësisht "Transferta për buxhete familjare dhe individë", gjatë vitit 2021, rezulton me një realizim në masën 90.24% më shumë, krahasuar me vitin 2020.

Shpenzimet kapitale totale (231) në fund të vitit 2021, rezultojnë me një realizim në masën 58.58% më shumë, krahasuar me vitin 2020.

Në terma totale buxhetore, shpenzimet e përgjithshme të buxhetit të vitit 2021 (përfshirë të gjithë zërat e buxhetit 600-601, 602-606, 231), krahasuar me shpenzimet e përgjithshme të buxhetit të vitit 2020 (përfshirë të gjithë zërat e buxhetit 600-601, 602-606, 231), janë realizuar në masën 16.84 % më shumë.

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I INSTITUCIONIT

1. Rregulla të organizimit dhe parimet themelore të funksionimit

Komisioni i Prokurimit Publik, edhe për sa i përket mënyrës së organizimit dhe funksionimit, mbështetet në përcaktimet e ligjit të prokurimit publik, i cili në nenin 30 pika 5 të tij parashikon se: *“Rregullat e hollësishme të organizimit dhe të funksionimit të Komisionit të Prokurimit Publik, miratohen nga vetë Komisioni me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij”*. Aktualisht, këto rregulla mbi organizimin dhe funksionimin e komisionit, janë detajuar në “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, e cila është miratuar me vendimin e Komisionit me nr.766/2021, datë 13.10.2021. Kjo rregullore ka mundësuar qasjen me ndryshimet dhe risitë e ligjit të ri të prokurimit publik, si dhe kornizimin në mënyrë më të plotë, të organizimit të funksionimit të organit kolegjal të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të institucionit të Komisionit, duke përfshirë që nga statusi i Komisionerit, kompetencat e Kryetarit

dhe Nënkyetarit, detyrat e anëtarit, administratën e institucionit, parimet e shqyrtimit kolegjal, hedhjen e shortit, veprimtarinë paraprake të komisionit, përcaktimin e rendit të ditës së mbledhjes, deri në marrjen e vendimit nga Komisioni.

Një pjesë e posaçme në këtë rregullore, tërësisht risi, janë edhe krerët mbi proceset e shqyrtimit të ankesave duke filluar nga: 1) Kreu që rregullon procesin e shqyrtimit të ankesave lidhur me procedurat e prokurimit publik; 2) Kreu për shqyrtimin e ankesave të Koncesioneve/PPP; 3) Kreu për shqyrtimin e ankesave për procedurat e përshpejtuara të rindërtimit; 4) Kreu për shqyrtimin e ankesave të lejeve minerare, si dhe 5) Kreu për shqyrtimin e ankesave për procedurat në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Gjithashtu një sërë risish janë parashtruar si më poshtë vijon:

- Parashikimi mbi të drejtën e Komisionit të Prokurimit Publik, që të publikojë thirrjen për specialistë dhe ekspertë të pavarur;
- Parashikimi i operatorëve ekonomikë të huaj, të cilët nuk e njohin gjuhën shqipe, për të marrë pjesë në seanca dëgjimore duke u asistuar nga një përkthyes, i cili si rregull sigurohet nga lista e ekspertëve të Komisionit, të cilët janë të licencuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, me kërkesë të palës.
- Parashikimi mbi zhvillimin e mbledhjeve të hapura/seancave dëgjimore, kur Komisioni gjykon të nevojshme, që për zgjidhjen e çështjes, nevojitet prania e palëve për të dëgjuar mbi provat dhe pretendimet e tyre;

- Parashikimi i detyrimit të autoritetit kontraktor, për zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, brenda 5 ditëve nga marrja dijeni;
- Parashikimi i sanksioneve në rast të refuzimit të autoritetit ose entit kontraktor për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik;
- Parashikimi i së drejtës së operatorëve ekonomikë ankimes, që në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, mund të paraqesin pranë KPP-së qëndrimin e tyre me shkrim, lidhur me vendimmarrjen e komisionit të shqyrtimit të ankesës së autoritetit kontraktor, nga e nesërmja e vënies në dijeni mbi këtë vendimmarrje;

Kjo rregullore, ka detajuar edhe koncepte të reja si parimet e open data, sipas së cilave të dhënat janë të disponueshme lirisht për t'u njohur nga të gjithë pa kufizime, koncept që vjen në funksion të sistemit të ri të menaxhimit të ankesave nga Komisioni i Prokurimit Publik, nëpërmjet të cilit ofrohen shërbime digjitale për pranimin, regjistrimin dhe procese të shqyrtimit (marrjes së informacionit nga autoritetet Kontraktore) e ankesave. Gjithashtu, në funksion të transparencës së veprimtarisë vendimmarrëse të këtij organi kolegjal, parashikohen përcaktime mbi publikimet e raportimeve periodike, si ato mujore, tremujore dhe ato vjetore, ku të dhëna të detajuara ofrohen publikisht nëpërmjet portalit kpp.al.

Komisioni i Prokurimit Publik, me veprimtarinë e tij në cilësinë e një organi administrativ që shqyrton ankesat, luan gjithashtu një rol të rëndësishëm për rritjen e besimit të palëve nëpërmjet vendimeve të paanshme, duke garantuar mbrojtje ligjore për të gjithë pjesëmarrësit në procedurat e prokurimit publik, procedurat e koncesioneve/partneritetit publik privat, ankandeve publike, si dhe procedurat konkurruese të dhënies së lejeve minerare.

Kjo praktikë, e bazuar edhe në praktikat më të mira për procedurat e rishikimit administrativ, ka ndikimin e saj pozitiv, në zhvillimin sa më të drejtë dhe efikas të procedurave të prokurimit nga autoritetet kontraktore, duke synuar parandalimin e çdo veprimi të kundërligjshëm që cenon interesat publikë në radhë të parë, interesat e operatorëve ekonomikë, cenon parimin e transparencës, barazisë, si dhe konkurrencës, e për më tepër përdorimin me ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet të fondeve publike.

2. Struktura dhe organika

Struktura dhe organika, numri i punonjësve, si dhe buxheti i Komisionit të Prokurimit Publik, miratohen nga Kuvendi, referuar përcaktimeve të ligjit nr. nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" ligjit nr.9584, datë 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj" (i ndryshuar) dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar).

Struktura, organika dhe numri i punonjësve aktual të Komisionit të Prokurimit Publik, janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr.65, datë 29.10.2020, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionit të Prokurimit Publik", vendim i cili sipas pikës 5 të tij, hyri në fuqi më 29 tetor 2020.

Me strukturën e miratuar me vendimin e Kuvendit nr.65/2020, datë 29.10.2020, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Komisionit të Prokurimit Publik", numri total i punonjësve, vijon të jetë i njëjtë në një numër total prej 36 punonjësish. Për sa i përket administratës së institucionit të Prokurimit Publik, inspektorët tashmë janë të organizuar në varësinë e Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe të organit kolegjal të Komisionit të Prokurimit Publik. Pra, inspektorët kanë varësi të dyfishtë, nga Sekretari i Përgjithshëm dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik. Numri i inspektorëve me organikën e re, është 15 (pesëmbëdhjetë) inspektorë me profile juristë, ekonomistë dhe inxhinierë, profile të cilat janë të nevojshme, duke konsideruar kompleksitetin e çështjeve të cilat merr në shqyrtim komisioni.

Gjithashtu, funksionon edhe Drejtoria e Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës, e cila përbëhet nga dy sektorë, përkatësisht Sektori i Monitorimit të Zbatimit të Vendimeve dhe Shërbimit Ligjor, i organizuar me 1 (një) Përgjegjës Sektori dhe 2 (dy) Specialistë (juristë) dhe Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Burimeve Njerëzore, i organizuar me 1 (një) Përgjegjës Sektori, 6 (gjashtë) Specialistë dhe 2 (dy) Punonjës Administrativë.

Bazuar në aktet nënligjore të sipërcituara, organika dhe struktura e Komisionit të Prokurimit Publik është si më poshtë vijon: Organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës në Komisionin e Prokurimit Publik:


Pozicioni	Kategoria	Nr. Punonjësish
Kryetar		1
Sekretar		1
Nënkryetar		1
Anëtar		3
Këshilltar	II-b	1
Sekretar i Përgjithshëm	I-b	1
Drejtor	II-b	1
Inspektor	III-a	15
Sektori i Monitorimit të Zbatimit të Vendimeve dhe Shërbimit Ligjor		
Përgjegjës Sektori	III-a	1
Specialist jurist	III-b	2
Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Burimeve Njerëzore		
Përgjegjës Sektori	III-a	1
Specialist (IT)	III-b	2
Specialist (Financë/Buxhet)	III-b	1
Specialist (Arkiv/Protokoll)	IV-a	1
Redaktor Letrar	III-b	1
Specialist i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënive me Jashtë	III-b	1
Sanitar		1
Shofer		1

Struktura në Komisionin e Prokurimit Publik

Në lidhje me këtë strukturë të miratuar nga Kuvendi edhe gjatë vitit 2021, fokusi i institucionit ka qenë në rritjen e kapaciteteve të stafit. Në zbatim të vendimit të ristrukturimit për pozicionin e “Sekretarit të Përgjithshëm” të Komisionit të Prokurimit Publik, për të cilin procedurat e rekrutimit u ndoqën në fund të vitit 2020, në muajin janar të vitit 2021, u konkludua me fillimin e marrëdhënive të punës.

Prej 1 janarit deri në 31 dhjetor 2021, janë ndjekur procedurat e rekrutimit për pozicionet vakante.

Konkretisht, deri në 31 dhjetor 2021 është përmbyllur procesi dhe janë rekrutuar 7 pozicione me status nëpunësi si vijon: **2 (dy) Inspektorë në profilet juristë dhe inxhinier, 1 (një) Drejtor, i Drejtorisë së Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës, 1 (një) Përgjegjës i Sektorit, të Monitorimit të Zbatimit të Vendimeve dhe Shërbimit Ligjor, 1 (një) Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse dhe Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Monitorimit, 1 (një) Redaktor Letrar, 1 (një) Specialist IT.**



Gjithashtu, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1151, datë 24.12.2020, janë ndjekur procedurat administrative dhe janë lidhur kontratat e punës për dy (2) punonjës mbështetës, specifikisht (1) një operator dhe (1) një punonjës protokoll.

Në zbatim të vendimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr.52, nr.53, nr.54 datë 27.05.2021 “Për emërim në detyrë” kanë filluar marrëdhëniet e punës dhe ato financiare në fund të muajit qershor 2021, 3 (tre) anëtarë të rinj të Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Politika të menaxhimit të burimeve njerëzore

Komisioni i Prokurimit Publik edhe gjatë vitit 2021, ka synuar të ndjekë një politikë të burimeve njerëzore, që ka në fokus rritjen e kapaciteteve dhe profesionalizmin, mishërimin e vlerave, parimeve, duke pasur si objektiv, që si anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik edhe stafi administrativ, të jenë të pajisur me aftësi dhe dije të përditësuara dhe të dëshmojnë angazhim maksimal ndaj zbatimit të parimeve etike, për të kryer veprimtarinë e tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe me efikasitet maksimal.

Aktualisht nga 32 (përfshirë dy punonjës administrativë dhe një punonjës mbështetës) punonjës të Komisionit të Prokurimit Publik, 23 prej tyre janë femra dhe 9 prej tyre meshkuj. Moshë mesatare e punonjëseve femra është 39 vjeç, ndërsa për punonjësit meshkuj është 34 vjeç. Punonjës me arsim të lartë janë gjithsej 31, nga të cilët 22 femra dhe 9 meshkuj. Punonjës me arsim të mesëm janë gjithsej 1, nga të cilët 1 femër dhe 0 meshkuj.

Gjatë vitit 2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka bërë një menaxhim të mirë të burimeve njerëzore, duke mundësuar trajtimin e një numri të lartë ankesash të paraqitura nga operatorë të ndryshëm ekonomikë, të cilat për vitin 2021, janë në një numër pak më të lartë krahasuar me vitin 2020.

Konkretisht, në Komisionin e Prokurimit Publik janë gjithsej 23 (njëzet e tre) nëpunës civil, pjesa më e madhe e të cilëve kanë kryer trajnimin e detyruar pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), në zbatim të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe janë konfirmuar si të tillë. Gjatë vitit 2021, kanë kaluar me sukses periudhën e provës 5 (pesë) punonjës, duke u konfirmuar nëpunës civil. Dy prej nëpunësve të rekrutuar gjatë 2021, janë aktualisht në periudhë prove dhe vazhdojnë të kryejnë rregullisht trajnimin (uebinarët) nën mbikëqyrjen e ASPA-së dhe në përputhje të plotë me legjislacionin e nëpunësit civil në fuqi.

Komisioni i Prokurimit Publik, ka në fokus rritjen e kapaciteteve dhe në këtë kontekst në bashkëpunim të ngushtë me ASPA-n, siguron rregullisht pjesëmarrjen në trajnimet e zhvilluara nga kjo e fundit, duke vënë në dispozicion të stafit kalendarët e trajnimeve, si dhe duke nxitur pjesëmarrjen në trajnimet sipas fushave që janë me interes, sipas profilit dhe detyrave funksionale të gjithsecilit.



32 punonjës

23 femra

9 meshkuj



39 vjeç, moshë mesatare për seksin femër,

34 vjeç, moshë mesatare për seksin mashkull



31 punonjës me arsim të lartë nga të cilët 22 femra dhe 9 meshkuj



1, punonjës me arsim të mesëm nga të cilët 1 femër dhe 0 meshkuj

Në funksion të përditësimit dhe pasurimit të dijeve, si dhe shkëmbimit të eksperiencave profesionale, stafi i Komisionit të Prokurimit Publik ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh dhe aktiviteteve të shkëmbimit profesional, të cilat për shkak të vijimit të kufizimeve për shkak të pandemisë Covid-19, janë zhvilluar në formë uebinarësh, apo uorkshope online.

Trajnime 2021

Janar

26 Janar 2021, trajnimi i zhvilluar nga SIGMA me temë “Realiteti i Sistemit të Shqyrtimit të Prokurimit Publik dhe sfidat pas Covid-it”. Pjesa I.

Maj

11 Maj 2021, trajnimi i zhvilluar nga SIGMA me temë “Shqyrtimi Efektiv dhe Eficient i Ankesave: Çështjet e përzgjedhura”.

21 Maj 2021, trajnimi i zhvilluar nga SIGMA me temë “E drejta e rastit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian, e rëndësishme për ligjin dhe praktikën e prokurimit publik shqiptar”.

Korrik

5 - 6 Korrik 2021, trajnimi i zhvilluar nga EURALIUS me temë “Acquis e Prokurimit Publik e BE-së - hyrje”.

Tetor

12 Tetor 2021, trajnimi i zhvilluar nga SIGMA me temë “Ligji i Ri i Prokurimit Publik në Shqipëri - ndryshimet në zbatimin e tij në praktikë”.

13 Tetor 2021, trajnimi i zhvilluar nga SIGMA me temë “Uorkshop për anëtarët e rinj dhe punonjësit e KPP-së “ Rëndësia e integritetit, etikës dhe qëndrueshmërisë në vendimmarrje.”

Dhjetor

1 Dhjetor 2021, trajnimi i zhvilluar nga SIGMA me temë “E drejta e rastit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian, e rëndësishme për ligjin dhe praktikën e prokurimit publik shqiptar”. Pjesa II.

Shtator

Dhjetor

Shtator-Dhjetor 2021, cikli 13 Javor i trajnimeve të zhvilluara pranë Universitetit të Tiranës, në kuadër të realizimit të marrëveshjes së bashkëpunimit dhe marrëveshjes financiare, të iniciuara nga Komisioni i Prokurimit Publik. Gjatë këtij cikli trajnimi, janë trajtuar 13 (trembëdhjetë) tema në fushat ekonomik, juridik dhe gjuhë e huaj (anglishte ligjore) në një total prej 195 orësh, nga pedagogë të fakulteteve respektive.

Fushat e trajtuara gjatë seancave të trajnimit janë: E Drejta Administrative; E Drejta Penale; Veprat penale në fushën e prokurimeve; Kontratat Publike dhe Zgjidhjet e Mosmarrëveshjeve; Auditimi i procedurave të prokurimit publik; Shoqëritë Tregtare; Teknika Legjislative; Financë Publike; Analiza e Pasqyrave Financiare dhe Raportimi Financiar; Dokumenti Elektronik; Analiza e tregut, Kontratat dhe mënyra e pagesës së punëmarrësve; Gjykata Europiane e Drejtësisë; Anglishte Ligjore.

Trajnime të ndryshme individuale, në total 55 (pesëdhjetë e pesë) zhvilluar nga ASPA, të cilat për shkak të situatës dhe kufizimeve të pandemisë Covid-19, janë zhvilluar në formë uebinarësh.



DIGJITALIZIMI I SHËRBIMEVE

Një reformë për të promovuar transparentën dhe përmirësuar sistemin e prokurimit publik

Projekti i digjitalizimit të shërbimeve dhe ngritjes së kapaciteteve, në Komisionin e Prokurimit Publik ka filluar prej vitit 2020, për *ngritjen e sistemit elektronik për menaxhimin e ankesave.*

Në këtë mënyrë, në respekt të parimit të deburokratizimit dhe të efikasitetit, KPP-ja synon jo vetëm përshtetjen e procedurave, por gjithashtu edhe shpërndarjen e kostove shtesë, që operatorët ekonomikë kryejnë pranë institucionit për veprimet procedurale.

Komisioni i Prokurimit Publik, në kuadër të digjitalizimit të shërbimit të shqyrtimit elektronik të ankesave, më datë 28.07.2020, nisi punën për ngritjen e sistemit të ri të E-Ankesave dhe Menaxhimit të E-Ankimeve, sistem i cili u zhvillua pas një pune të gjatë dhe sistematike me Komisionin e Prokurimit Publik dhe u lançua më 27.10.2021.

Falë mbështetjes së Qeverisë, Komisioni i Prokurimit Publik, arriti të vërë në jetë një prej reformave më të rëndësishme të dhjetë viteve të fundit, atë të digjitalizimit të shërbimeve, dhe krijimin e një sistemi unik në Ballkanin perëndimor dhe më gjerë të E-Ankesave.

Nëpërmjet *Sistemit të Menaxhimit dhe Shqyrtimit të Ankesave Elektronike*, të gjitha ankesat në lidhje me procedurat e prokurimit publik, procedurat e prokurimit publik për rindërtim, koncesionet dhe partneritetet publike private, ankandet publike dhe lejet minerare, dorëzohen në mënyrë elektronike nëpërmjet platformës unike qeveritare E-Albania, si dhe menaxhimi i ankesave tashmë bëhet në mënyrë elektronike. Ky sistem, i krijuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, ka mundësuar kryerjen në rrugë digjitale, të çdo detyre dhe procesi pune parashikuar nga ligji, si për Autoritetet Kontraktore ashtu dhe për Komisionin e Prokurimit Publik.

Nëpërmjet sistemit E-Ankesa, të gjithë operatorët ekonomikë vendas dhe ndërkombëtarë, kanë mundësinë të paraqesin ankesat dhe argumentet e tyre, si dy shërbime të ndara, duke eliminuar çdo kosto shtesë dhe çdo kontakt të drejtpërdrejtë me çdo institucion shtetëror (autoritete kontraktore), duke përfshirë edhe vetë Komisionin e Prokurimit Publik.

Gjithashtu, një ndër risitë e sistemit është fakti, se sistemi është i lidhur me Sistemin e Prokurimit Elektronik, Sistemin Kombëtar të Regjistrimit të Bizneseve dhe sistemin e organeve tatimore.

Sistemi u mundëson operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve kontraktore, të nënshkruajnë në mënyrë elektronike dokumentet dhe aktet, duke shmangur kështu nevojën e printimit të tyre, me ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu, tarifa e ankesës mund të paguhet nëpërmjet sistemit unik të pagesave të qeverisë në e-Albania ose edhe me transfertë bankare.

Nëpërmjet këtij sistemi, autoritetet kontraktore kanë mundësinë të kryejnë çdo komunikim në formë elektronike me operatorët ekonomikë gjatë shqyrtimit të ankesave, duke përfshirë edhe dërgimin e vendimit përfundimtar përmes sistemit. Sistemi mundëson gjithashtu, dërgimin e vendimit edhe tek operatori ekonomik i interesuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, shqyrton çdo ankesë të paraqitur në mënyrë

elektronike nëpërmjet platformës së menaxhimit të ankesave, përfshirë çdo lidhje, votimin elektronik, si dhe njofton në mënyrë elektronike palët në proces dhe palët e interesuara, në kohë reale, me një vendim dhe vulë të nënshkruar elektronikisht. Sistemi ofron siguri dhe garanci për ndërhyrje të paautorizuara. Ky sistem, duke rritur efikasitetin e procedurave të dorëzimit dhe shqyrtimit të ankesave, kontribuon edhe në përmirësimin e një prej indikatorëve më të rëndësishëm, të kohës së shqyrtimit të ankesës, duke përmirësuar kështu ndjeshëm, performancën e Komisionit të Prokurimit Publik në procesin e tij vendimmarrës.

Vlen të theksohet, se krahas sistemit është krijuar një faqe e re zyrtare e KPP-së, e cila mundëson akses të plotë të bazës së të dhënave të ankesave dhe vendimmarrjes në tri regjistra publikë, atë të ankesave, vendimeve dhe historikut të vendimeve. Tashmë çdo subjekt i interesuar, jo vetëm ka informacion të plotë për të gjithë aktivitetin, por mundësohet që nëpërmjet Smart Search, të kërkojë pa humbur kohë informacionin e nevojshëm.

Komisioni ka bashkëpunuar me Open Contracting Partnership, që përmes këtij uebsajti, të mundësojë jo vetëm transparencë të plotë bazuar në parimet e open data, por edhe statistika në kohë reale. Gjithashtu, informacioni në lidhje me ankesat, vendimet dhe statistikat, mund të shkarkohet edhe në formatin JSON. Kjo faqe e re mundëson publikimin e statistikave në kohë reale, buletinin mujor dhe informacione për çdo subjekt të interesuar, duke krijuar akses edhe për personat me dëmtime shikimi (verbëri, verbëri ngjyrash dhe shikim të dobët) nëpërmjet një motori të veçantë aksesi të implementuar në faqen tonë zyrtare, shërbim i ofruar për herë të parë nga një institucion publik në Shqipëri.

Për të mundësuar aksesimin e këtij sistemi, Komisioni i Prokurimit Publik inicioi zhvillimin e trajnimeve për të gjitha autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë lidhur me funksionimin e sistemit të ri digjital të ankesave (e-ankesa). Trajnimet u zhvilluan falas në të gjitha qarqet e vendit si më poshtë vijon:
- Dibër, Kukës, Fier, Berat, Gjirokastrë, Vlorë, Shkodër, Lezhë, Elbasan, Korçë, Tiranë, Durrës.

Para zhvillimit të trajnimeve, Komisioni i Prokurimit Publik, me shkresën nr. 1972 protokoli datë 15.10.2021, ka njoftuar 1700 autoritete publike në të gjithë Shqipërinë, për mundësinë e trajnimit falas mbi projektin e digjitalizimit.


Në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, me anë të shkresës nr. 1973 protokoli, është kërkuar që të gjithë operatorëve ekonomikë t’iu shfaqet një mesazh i dedikuar në portalin E-Albania, si njoftim mbi datat e zhvillimit të trajnimeve.

Gjithashtu, me shkresën nr.2040 protokoli datë 20.10.2021 është njoftuar edhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë.

Nga seancat trajnuese të zhvilluara, janë trajnuar rreth 1000 operatorë ekonomikë dhe autoritete kontraktore me gjithsej 24 orë trajnimi.

TRAJNIMET JANË ZHVILLUAR, SI MË POSHTË VIJON:

Qarku Dibër – 4 Nëntor 2021	Qarku Shkodër 23 Nëntor 2021
Qarku Kukës – 5 Nëntor 2021	Qarku Lezhë – 24 nëntor 2021
Qarku Fier – 11 Nëntor 2021	Qarku Elbasan – 2 Dhjetor 2021
Qarku Berat – 12 Nëntor 2021	Qarku Korçë – 3 Dhjetor 2021
Qarku Gjirokastër -18 Nëntor 2021	Qarku Tiranë 13 – Dhjetor 2021
Qarku Vlorë – 19 Nëntor 2021	Qarku Durrës – 13 Dhjetor 2021



BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE AKTIVITETET

VII

Bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve të institucionit, Komisioni i Prokurimit Publik ka vijuar bashkëpunimin e nisur gjatë vitit 2020 me Universitetin e Tiranës, duke mundësuar lidhjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi, me datë 09.06.2021 nr.1014 Prot., dhe një marrëveshjeje financiare, me datë 24.09.2021 nr.1796 Prot., për rritjen e kapaciteteve dhe aftësive profesionale në fushën ligjore dhe ekonomike për personelin e KPP-së. Në mbështetje të marrëveshjeve të sipërcituara, u zhvillua një cikël trajnimi 13 javor pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe gjatë këtyre seancave u shqyrtuan 13 (trembëdhjetë) tema nga pedagogë të shquar, të 3 (tri) fakulteteve kryesore të Universitetit të Tiranës, Fakultetit Ekonomik, Fakultetit Juridik dhe Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

Temat janë trajtuar në një hark kohor prej 13 javësh, nga data 30 shtator 2021 deri në datën 20 dhjetor 2021. Për secilën fushë, u zhvilluan 15 (pesëmbëdhjetë) orë të ndara në 3 (tri) ditë kalendarike.

Temat e trajtuara gjatë seancave trajnimit janë të renditura si më poshtë:

1. E Drejta Administrative
2. E Drejta Penale, veprat penale në fushën e prokurimeve
3. Instrumentet ligjore ndërkombëtare që rregullojnë prokurimet publike
4. Kontratat publike dhe zgjidhjet e mosmarrëveshjeve
5. Auditimi i procedurave të prokurimit publik
6. Shoqëritë tregtare
7. Teknika legislative
8. Financë publike
9. Analiza e pasqyrave financiare dhe raportimi financiar
10. Dokumenti elektronik
11. Analiza e tregut, kontratat dhe mënyra e pagesës së punëmarrësve
12. Gjykata Europiane e Drejtësisë
13. Anglishte ligjore

Çështjet kryesore të trajtuara gjatë këtyre seancave, ishin të lidhura ngushtë me ndryshimet në ligjin “Për prokurimin publik”, si kanë ndikuar këto ndryshime në shqyrtimin e ankesave; vepra penale e mashtrimit kompjuterik dhe shkelja e barazisë

në tendera; kuptimi dhe llojet e kontratave publike; realizimi i vendimmarrjes për shpenzimet publike; analiza e konkurrencës, etj. Falë bashkëpunimit me pedagogët e Universitetit të Tiranës, të gjithë pjesëmarrësve iu janë vendosur në dispozicion materialet e trajnimit të prezantuara gjatë këtyre seancave.

Bashkëpunimi me Universitetin Politeknik të Tiranës

Komisioni i Prokurimit Publik edhe gjatë vitit 2021, ka vijuar bashkëpunimin ndërinstitucional, me Universitetin Politeknik të Tiranës, në disa aspekte me rëndësi të veçantë në procesin e hetimit administrativ, për një shqyrtim sa me korrekt, profesional dhe të paanshëm të ankesave lidhur me procedurat. Komisioni vijon bashkëpunimin për:

- a. Kryerjen e testimeve zyrtare mbi mostrat e produkteve të ndryshme pranë laboratorëve të akredituar të Universitetit Politeknik të Tiranës.
- b. Përfshirjen si ekspertë, të profesorëve të Universitetit të Tiranës në listën e ekspertëve të Komisionit të Prokurimit Publik;

Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës

Në ushtrimin e funksionit të shqyrtimit të ankesave, lidhur me procedurat e prokurimit publik, lejeve minerare, ankandeve, koncesioneve/PPP, një ndër elementet më të rëndësishme në këtë proces, është rritja e kapaciteteve institucionale për të përballuar volumin e punës, si dhe për t'i dhënë zgjidhje në zbatim korrekt të kuadrit ligjor në fuqi, ankesave komplekse. Në këtë kontekst, Komisioni i Prokurimit Publik, konsideron vijimin e bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës. Gjatë vitit 2021, krahas zhvillimit të takimeve zyrtare me përfaqësues të këtij institucioni, por edhe komunikimit zyrtar me shkresën me nr.1045 prot., datë 11.06.2021, ka dakordësuar zhvillimin e një cikli trajnimesh për 4 (katër) tema mbi çështje të prokurimit publik dhe konkretisht kjo e fundit është përfshirë në programin e vitit akademik 2021-2022, trajnimi me temë "Procedurat për prokurimin publik", në kuadër të Programit të Trajnimit Vazhdues (PTV) më datë 30-31 maj 2022, për 4 (katër) anëtarë të KPP-së dhe 2 (dy) inspektorë të rinj (6 zyrtarë të KPP-së).

Bashkëpunimi me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike

Në kuadër të mbarëvajtjes së procesit të hetimit administrativ dhe shqyrtimit të ankesave të fushës së prokurimit publik, rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së shqyrtimit

të çështjeve në këtë fushë, vijon bashkëpunimi me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike duke rekomanduar dhe duke kërkuar tema trajnimi me interes për nëpunësit civil të Komisionit të Prokurimit Publik. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi, mundësohet pjesëmarrja në trajnime dhe programe të vlefshme, për përditësimin e njohurive, për anëtarët dhe nëpunësit civil të Komisionit të Prokurimit Publik.

Bashkëpunimi me Agjencinë e Prokurimit Publik

Në kuadër të mbarëvajtjes së sistemit të prokurimeve publike, rritjes së efikasitetit dhe efikasitetit të sistemit të prokurimeve publike, Komisioni i Prokurimit Publik ka vijuar bashkëpunimin me Agjencinë e Prokurimit Publik.

Me anë të shkresës me nr. 982 prot, datë 04.06.2021, Agjencia e Prokurimit Publik i drejtohet Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë vendimmarrës në shqyrtimin e ankesave për bashkëpunim, në lidhje me hartimin e formularit standard të ankesave dhe formularit standard të argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar, në përputhje me ligjin 162/2020 "Për prokurimin Publik", si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Bashkëpunimi në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020-2023

Në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik, si një ndër institucionet kontribuese dhe bashkëpunuese, Komisioni i Prokurimit Publik ka raportuar lidhur me aktivitetet e zhvilluara, si dhe treguesit e performancës gjatë vitit 2020 dhe viti 2021.

Në datë 14 korrik 2021, me qëllim miratimin e strukturës monitoruese të SKPP-së, si edhe për të diskutuar lidhur me përgatitjen e raportit të monitorimit për vitin 2020 dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, u zhvillua mbledhja e Komitetit Drejtues, në të cilën mori pjesë edhe Kryetari i Komisionit të Prokurimit Publik, në cilësinë e anëtarit të KD-së.

Lidhur me monitorimin e aktiviteteve dhe të treguesve të performancës së Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020-2023, për vitin 2020 dhe Janar-Qershor 2021, në datë 23.12.2021, u zhvillua online mbledhja e Komitetit Drejtues të Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik, për miratimin e këtyre raporteve. Ajo që vihet re nga këto raporte, për **qëllimin e politikës 5 "Shqyrtimi dhe kontrolli i ankesave"**, është kontributi që ka dhënë Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të miratimit të ligjit 162/2020, i cili pati një përmirësim të dukshëm të dispozitave për sa i takon ankimit administrativ në këtë fushë, duke rikonceptuar procesin, me

qëllim lehtësimin e tij për palët, shmangien e zvarritjeve në procedurat e prokurimit që vijnë pikërisht nga ky proces, në përputhje me Direktivat përkatëse të BE-së, dhe ngritjen e kapaciteteve nëpërmjet rritjes së numrit të stafit dhe zhvillimit të trajnimeve.

Në nivel treguesish performance ka pasur arritje të dukshme, sikurse është ulja e përqindjes së numrit të ankesave të shqyrtuara jashtë afatit parashikuar në ligj, të cilat arritën në masën 22.1% gjatë 2020 nga 33.3% në 2019.

Ndërsa, në raportin gjashtëmuor të monitorimit janar-qershor 2021, ka vijuar rritja e kapaciteteve të stafit dhe në nivel treguesish performance, ka pasur arritje të dukshme, sikurse është ulja e përqindjes në bazë mujore të numrit të ankesave të shqyrtuara jashtë afatit, parashikuar në ligj për janar-qershor 2021, konkretisht 2.1%, 11.3%, 7.4%, 9.3%, 4.1% dhe 3.7%, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2020, ku përqindjet arritën respektivisht në 29.5%, 20.8%, 33.3%, 5%, 24% dhe 30.5%.

Bashkëpunimi me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit

Në vijim të reformës së digjitalizimit të shërbimeve, Komisioni i Prokurimit Publik edhe gjatë vitit 2021, ka bashkëpunuar me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Në vazhdimësi të këtij projekti është zhvilluar edhe procedura e prokurimit në ditët e para të vitit 2021 dhe operatori ekonomik fitues ka nënshkruar kontratën.

Ky bashkëpunim ka vijuar edhe më tej falë mbështetjes, punës së përbashkët dhe ekspertizës së dhënë nga ekipi i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Komisioni i Prokurimit Publik arriti të vërë në jetë sistemin elektronik të dorëzimit dhe menaxhimit të ankesave (e-ankesa), si dhe është realizuar zbatimi i kontratës dhe marrja në dorëzim e sistemit në një kohë rekord.

Është bërë e mundur ndërlidhja e sistemit të Komisionit të Prokurimit Publik me sistemin e Prokurimeve Elektronike, Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Mjaft e rëndësishme ka qenë mbështetja e dhënë nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, lidhur me dhënien e asistencës për operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore, në përdorimin e sistemit digjital të ankesave (e-ankesa).

Konferenca me temë “Sfidat e sistemit të Prokurimit Publik në Shqipëri dhe roli i Komisionit të Prokurimit Publik”

Në 20 maj 2021, me synim adresimin e problematikave dhe përballjen me sfidat e përbashkëta të së ardhmes, institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik, zhvilloi konferencën me temë “Sfidat e sistemit të Prokurimit Publik në Shqipëri dhe roli i Komisionit të Prokurimit Publik”. Në konferencë morën pjesë përfaqësues nga autoritetet kontraktore, operatorët ekonomikë, përfaqësues nga Sigma-OECD, përfaqësues nga Open Contracting Partnership, anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimit Publik. Konferenca u zhvillua online, me pjesëmarrjen e mbi 70-të përfaqësuesve të bizneseve, autoriteteve kontraktore dhe organizmave ndërkombëtare. Ndër temat kryesore të diskutuara në konferencë ishin:

- Reformat në Komisionin e Prokurimit Publik dhe ndikimi i mundshëm në sistem;
- Transparenca, pavarësia dhe efikasiteti, parimet kryesore në sistemet e rishikimit në prokurimin publik;
- Kontrata të hapura: hapja dhe transparenca për sisteme më të mira të rishikimit; shembuj nga diku tjetër;
- Sfidat e procesit të rishikimit lidhur me ankesat për dokumentet e tenderit dhe vendimet e vlerësimit në kontratat për punë/mallra dhe shërbime;
- Sfidat e sistemit të prokurimit dhe procesi i rishikimit;
- Sfidat me të cilat përballen Autoritetet Kontraktuese në procedurën e prokurimit dhe në procesin e rishikimit nga KPP-ja;
- Sfidat me të cilat përballen biznesi në procedurën e prokurimit dhe si ndihmon procesi i rishikimit.

Kjo konferencë përbën një event të rëndësishëm, duke sjellë më pranë subjektet e përfshira në procedurat e prokurimit publik, si dhe në drejtim të rritjes së transparencës.

Takimi i zhvilluar me zv. Kryetaren e Kuvendit

Zëvendëskryetarja e Kuvendit znj. Ermonela Felaj, priti në takim Kryetarin e Komisionit të Prokurimit Publik z. Jonaid Myzyri, i shoqëruar nga z. Gavin Hayman, drejtor ekzekutiv i Open Contracting Partnership dhe z. Karolis Granickas, menaxher i lartë i programit për Europën, Open Contracting Partnership.

Në këtë takim, u diskutua lidhur me nevojën për të qenë të asistuar me ekspertizën më të mirë në fushën e prokurimeve publike, financimit të paligjshëm, pastrimit të parave, dhe rolin e Kuvendit të Shqipërisë për përfitimin e kësaj ekspertize, si dhe reflektimin e saj në legjislacionin që trajton këto tema.

Znj. Felaj shprehu konsideratat e saj, për ndihmesën tejet të çmuar në implementimin e sistemit elektronik të ankesave lidhur me prokurimet publike dhe konfirmoi edhe njëherë mbështetjen e saj, për nismën mbi një projektligj të open data.

Akte / Rregullore të miratuara në vitin 2021

Gjatë vitit 2021, institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik, me qëllim mbështetjen e proceseve administrative të punës me akte rregullatore, ka punuar për hartimin dhe miratimin e një sërë aktesh administrative. Gjata vitit 2021, janë hartuar dhe miratuar aktet si vijon:

- **Rregullore e brendshme e grupit të monitorimit ad hoc, në lidhje me mbikëqyrjen e sjelljes së nëpunësve civil gjatë periudhës së fushatës elektorale** me nr.3511/1, datë 25.02.2021. Kjo rregullore përcakton rregullat normuese, për monitorimin dhe mbikëqyrjen e sjelljes së nëpunësve civil gjatë periudhës së fushatës elektorale.
- **Program i Transparencës** - miratuar me urdhrin e brendshëm nr.63, datë 29.03.2021 “Për miratimin e Programit të transparencës të rishikuar të Komisionit të Prokurimit publik; Programi i transparencës, hartohet në mbështetje të nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Ky program bën transparente veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik dhe vlerësohet si një mënyrë konkrete, përmes së cilës ndërtohet dhe rritet transparenca mbi punën institucionale, program i cili përditësohet në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të ligjit;
- **Procedura Antikorrupsion në Komisionin e Prokurimit Publik** - miratuar me urdhrin nr.96, datë 09.04.2021 “Për miratimin e procedurës antikorrupsion në Komisionin e Prokurimit Publik. Hartimi dhe miratimi i kësaj procedure është detyrim sipas përcaktimeve të udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (i ndryshuar).
